

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

RAMIZ ABDYLI,
STUDIUESI MODEL
I HISTORIOGRAFISË
SHQIPTARE

(konferencë e mbajtur më 10 qershor 2021)

33



Shkup, 2022

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 33 – 2022
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Prof. dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Besnik Rameti

Këshilli redaktues:
Prof. dr. Skender Asani
Prof. dr. Isamedin Azizi
Prof. dr. Sevdail Demiri
Doc. dr. Minir Ademi
Emin Azemi

Copyright©ITSHKSH, 2022
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978–608–4897–67–5

www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga:



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

RAMIZ ABDYLI,
STUDIUESI MODEL
I HISTORIOGRAFISË
SHQIPTARE

(konferencë e mbajtur më 10 qershor 2021)

33

SCUPI

Shkup, 2022



PËRMBAJTJA:

HAPJA E KONFERENCËS	7
----------------------------------	---

Skender ASANI: EMRI DHE VEPRA E PROF.RAMIZ ABDYLIT, NXITJE PËR PRURJET E REJA NË HISTORIOGRAFI	9
--	---

Arbër ADEMI: NJË PERSONALITET – FRYMËZIM PËR SHUMË GJENERATA	12
--	----

Ylber SELA: DY BOTIMET E REJA, FORMA MË E MIRË PËR TA SHËNUAR LIDHJEN E PRIZRENIT	13
---	----

Mehmet PRISHTINA: ITSHKSH, ADRESË KREDIBILE E KËRKIMIT SHKENCOR	15
---	----

KUMTESAT E STUDIUESVE	17
------------------------------------	----

Marenglen VERLI: RAMIZ ABDYLI – PROFESORI DHE MIKU I NDERUAR	19
--	----

Naim HALIMI: KONTRIBUTI I PROF.DR RAMIZ ABDYLIT NË AVANCIMIN HISTORIOGRAFISË SHQIPTARE	23
--	----

Fehari RAMADANI: RAMIZ ABDYLI, PROFESORI QË MOTIVONTE	27
---	----

Qerim DALIPI: RAMIZ ABDYLI DHE KONTRIBUTI I TIJ NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE (DERI NË PRAG TË LIDHJES SË PRIZRENIT)	32
--	----

Isamedin AZIZI: KONTRIBUTI SHKENCOR I PROF. RAMIZ ABDYELIT NË INSTITUTIN E HISTORISË NACIONALE –SHKUP	41
--	----

Emin AZEMI: ESE MBI PROFILIN INTELEKTUAL E NJERËZOR TË PROF.DR. RAMIZ ABDYLIT	48
Fitim RIFATI: VËSHTRIM MBI VEPRAT E BOTUARA TË PROF. DR. RAMIZ ABDYLIT, NË KUADËR TË INSTITUTIT TË HISTORISË NË PRISHTINË	59
Alban DOBRUNA: KONTRIBUTI I PROF. DR. RAMIZ ABDYLIT NË REVISTËN “KOSOVA”	67
Besnik RAMETI: PROF. DR. RAMIZ ABDYLI, SI LIGJËRUES DHE REKTOR NË UNIVERSITETIN E TETOVËS	74
 PROMOVIMI I DY VEPRAVE TË PROF.DR. RAMIZ ABDYLIT	 79
 Skender ASANI: KËTO VEPRA DO TË JENË SHTYLLA KRYESORE E SHKRIMIT TË HISTORISË SË SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË.....	81
Sevdail DEMIRI: SHQIPTARËSIA E SHKUPIT SHKENCËRISHT PO BETONOHET ME DY VEPRA MADHORE TË PROF. ABDYLIT.....	85
Emin AZEMI: MONOGRAFIA “VEPRIMTARIA E KLUBIT TË SHKUPIT (1908–1912)” NJË GRAVURË E STILIZUAR MBI MERMERIN E KUJTESËS SONË KOMBËTARE.....	89
 SHTOJCË – FOTOGRAFI.....	 95

HAPJA E KONFERENCËS

SKENDER ASANI

Drejtor i ITShKSh–Shkup

EMRI DHE VEPRA E PROF.RAMIZ ABDYLIT, NXITJE PËR PRURJET E REJA NË HISTORIOGRAFI

Është një ditë e shenjtë për shqiptarët jo vetëm për në Shkup por edhe gjithë botën dhe nuk kamë fjalë për të përshkruar për Lidhjen shqiptare të prizrenit, sa është thënë shumë është thënë edhe aq pak për shkak se ditë për ditë kemi prurje të reja ndërsa në çdo manifestim që kemi mbajtur këto dy tre dekada dhe më pare nuk është lejuar të manifestohet Lidhja Shqiptare e Prizrenit kemi folur për Abdyl Frashërin shtyllën kryesore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit por asnjëherë nuk kemi folur për një njeri, për një personalitet i cili është në frymën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe përçon jo vetëm prurjet e reja në historiografinë shqiptare jo vetëm për të tanishmen por është frymëzim për të ardhmen sepse Lidhja Shqipëtare e Prizrenit në atë periudhë kohore nuk i realizoj ato qëllime jo pse nuk dëshiro, jo pse nuk ishte mobilizua, por e penguan Fuqitë e Mëdha dhe shtetet sllave dhe Rusia ndërsa poashtu fryma e lidhjes së prizrenit nuk u shua ajo vazhdoi më tutje edhe gjatë kryengritjeve të ndryshme të cilat ndodhën por edhe ditët e sotme që do të thotë konferenca të ndryshme e penguan lidhjen shqiptare të prizrenit jo rastësisht në lidhjen shqiptare të prizrenit e kemi lidhur me një personalitet i cili e meriton të jetë në këtë datë dhe angazhimin e tij shkencor ose gjysmë shekullor për vepritarin e lidhjes shqiptare të prizrenit por edhe lëvizjes kombëtare shqiptare nuk mund të përshkruhet jo të tjerët unë nuk mund ta përshkruaj

me fjalë Profesor Ramiz Abdylin për atë unë do të lexoj disa gjëra të cilat i kam nxjerrë në letër që të jem më i saktë për Profesor Ramiz Abdylin.

Sot na ka bërë bashkë prof.dr. Ramiz Abdyli dhe 143 vjetori i Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Jo rastësisht po e vendosi në një korrelacion emrin profesorit me këtë ngjarje të lavdishme të popullit shqiptar, për arsye se ishte pikërisht ai që injektoi në formimin tim nervin e reagimit profesional ndaj proceseve historike që ishin të lidhura ngushtë me Shkupin dhe ngjarjet që e bënin dikur këtë qytet një amfiteatër të madh ku ballafaqohesh Lindja dhe Perëndimi, robëria dhe liria, lufta për shtet kombëtar dhe ikja në periferi të atij shteti.

Prof. Ramiz Abdyli paraqet aktualisht një prej emrave më emblematic në historiografinë shqiptare, vepra e të cilit do të mbetet një prej dhuratave më të çmuara në trashëgiminë tonë të shkruar. Ai pati një qëndrim konstant ndaj të vërtetës historike, duke i dhënë asaj bazën e argumentimit shkencor, që e mbështeti në hulumtime disadekadëshe.

Fryt i atij hulumtimi janë edhe dy veprat që posa kanë dalur nga shtypi, të cilat do ti promovojmë sot, e që paraqesin një prurje mjaft ambicioze nga pena e shkathët e prof. dr. Ramiz Abdylit, me çka ITSHKSH në fakt po e vazhdon traditën që ai e kishte trasuar në heqjen e pluhurit të harresës nga ngjarjet e rëndësishme kombëtare, siç ishte Dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Shkup, pastaj Klubi Bashkimi i Shkupit etj.

Në fakt këto dhe vepra të tjerë do të jenë edhe bërthama e një kapitulli të ri që do të shkruhet mbi Historinë e shqiptarëve të Maqedonisë, i cili do t'i bashkëngjitet një projekti më të madh mbi Historinë e shqiptarëve, ku emri i prof.dr. Ramiz Abdylit do të jetë një zë artikulues i shkencave albanologjike dhe një referencë e

dobishme për studiuesit e nesërm që do të merren me historinë e Dardanisë dhe epiqendrën e saj Shkupin.

Ajo çka më lidh mua me prof. Ramiz Abdylin ka të bëjë drejtpërdrejt me ndikimin që ai kishte në formimin tim profesional, që nga ligjeratat e para universitare, të cilat ishin një frymëzim i vërtetë mbi ngjarjet e bujshme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të kryengritjes së Dervish Carës dhe çlirimin Shkupit nga kryengritësit shqiptarë.

Për një historian janë shumë të rëndësishme shkallët prej nga ngrihet ai në karrierë. Mund të them se jemi me fat që gjenerata ime patëm Prof. dr. Ramiz Abdylin shkallën më të sigurt për t'u ngjitur në pikat e vrojtimit për të shikuar të vërtetat historike me sy më objektiv. Misioni i tij ende nuk është përmbyllur, sepse për një historian të kalibrit të prof.dr. Ramiz Abdylit misionet janë të plota vetëm atëherë kur rrugën e tij do ta trasojë një plejadë historianësh të rinj, me ambicie e këndvështrime të reja shkencore profesionale.

Uroj që kjo rrugë të jetë sa më e frytshme me prurjet e reja, ndërkohë që emri dhe vepra e prof. Ramiz Abdylit të vazhdojnë të jenë frymëzim për historiografinë shqiptare, e cila do të shkruhet sipas standardeve që ai i vendosi tash e disa dekada.

Shkup, 10 qershor, 2021

*ARBËR ADEMI**Deputet*

NJË PERSONALITET – FRYMËZIM PËR SHUMË GJENERATA

Me të vërtetë ndjej kënaqësi që sot jam në mesin tuaj në këtë ditë të shënuar, në këtë ditë të veçantë për gjithë shqipëtarët anë mbanë, kur po e shënojmë 143-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit në mënyrë të veçantë. Këtë përvjetor po e shënojmë më së miri nëpërmjet një konference dhe nëpërmjet promovimit të dy librave studimore të prof.dr Ramiz Abdylit, i cili pa dyshim si personalitet përbën frymëzim për shumë gjenerata, e veçanërisht gjeneratave të zonës së Kumanovës dhe Likovës, duke filluar nga babai im apo edhe nga doktori që e kemi këtu, dhe nga shumë të tjerë të cilët ishin nxënës të tij, studentë të tij apo edhe bashkëvendas të tij.

Prof. Abdylit, me të vërtetë përbën një personalitet model, si në aspektin e shkencëtarit, ashtu edhe në aspektin e një figure kombëtare, i cili ka përcaktuar asetin apo vijën e pastërt kombëtare, të cilën e kanë ndjekur vazhdimisht dhe nuk ka patur zbrapsje apo devijim nga e njëjta deri në ditët e sotme.

Andaj, kam nderin që prof. dr. Ramiz Abdylin ta përgëzoj për gjithë kontributin e tij prej historiani dhe edukatori gjeneratash, duke i dëshiruar shumë shëndet, shumë suksese të tjera, me një veprimtari edhe të mëtutjeshme shkencore, e cila padyshim do të përbëjë një trashëgini të pasur për ne dhe për gjeneratat e ardhshme në drejtim të thellimit të mëtejshëm të studimeve tona për historinë kombëtare.

Ju faleminderit shumë!

YLBER SELA

Drejtor i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe – Shkup

DY BOTIMET E REJA, FORMA MË E MIRË PËR TA SHËNUAR LIDHJEN E PRIZRENIT

Të nderuar miq!

10 Qershori ose Dita e Lidhjes së Prizrenit, pa dyshim, është njëra nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Prandaj është e kuptueshme se edhe shënimi i saj medoemos paraqet një detyrim kombëtar për faktin se duhet të jemi mirënjohës ndaj atyre që i hodhën themelet e shtetit, kombit dhe gjuhës, të përulemi para sakrificës së tyre për ideale të shtrenjta kombëtare dhe, veçanërisht, ta vazhdojmë rrugën e tyre në aspektin ndihmesës kombëtare në të gjitha format e mundshme.

Po ashtu, edhe dy librat që i promovojmë sot, “Shkupi në Lidhjen e Prizrenit” dhe “Veprimtaria e Klubit të Shkupit” të autorit Ramiz Abdyli, janë një formë e veçantë për ta shënuar këtë datë. Me anë të tyre hidhet dritë e mjaftueshme për të kuptuar qartë se shqiptarët e kësaj qendre, siç ishte Shkupi, nuk qëndruan fare indiferentë ndaj ngjarjeve të kohës, por u bënë pjesë aktive e tyre duke dhënë kontributin kombëtar, politik, shoqëror, kulturor, arsimor etj. Duke qenë se ne, brezat e sotëm që jetojmë dhe veprojmë në Shkup, jemi një vazhdimësi e kësaj kauze, aq më tepër na bën të ndihemi krenarë.

Në këtë kontekst dua të theksoj se Lidhja e Prizrenit ishte organizata më largpamëse dhe më strategjike shqiptare e cila e ndërtoi vetëdijen mbarëkombëtare për shtetin, kombin dhe gjuhën. Në përputhje me këtë frymë, edhe Agjencia e Zbatimit të Gjuhës,

të cilën më ra fati që ta udhëheq unë, vazhdon të punojë me përkushtim që gjuha shqipe të zbatohet në institucionet shtetërore, duke përmbushur amanetin e pararendësve tanë që vepruan në kuadër të Lidhjes së Prizrenit. Pa ruajtjen dhe pa kultivimin e gjuhës shqipe, nuk do të kemi as komb. Prandaj do të bëjmë çmos që ta vazhdojmë misionin tonë me ndërgjegje e përgjegjësi të plotë.

Uroj që librat e këtillë të shërbejnë si një dritë udhëzuese për brezat e sotëm, për të kuptuar dhe për të punuar për kauzën kombëtare.

Ju faleminderit!

MEHMET PRISHTINA

Studiues dhe pasardhës i Hasan Prishtinës

ITSHKSH, ADRESË KREDIBILE E KËRKIMIT SHKENCOR

Përsëritet zonja e zotrinj, studiues i çmuar prof.dr Ramiz Abdylit, i nderuar ish ministër i Arsimit dhe deputet Arbër Ademi.

Sot jam i nderuar që më jepet rasti të paraqitem para këtij auditeriumi, për çka e falenderoj drejtorin Asani për ftesën, duke iu dëshiruar punë të mbarë në këtë konferencë shkencore kushtuar dojaenit të historigrafisë shqiptare prof.dr Ramiz Abdylit, puna e të cilit na ka bërë sot bashkë për ta nderuar atë për gjithë kontributin shkencor që ka dhënë ai në afirmimin e ngjarjeve dhe shumë personaliteteve të çmuara.

Profesor Abdylit shquhet për një aktivitet ambicioz për lëvizjen tonë kombëtare që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri te ngjarja e bujshme e çlirimit të Shkupit nga kryengritësit shqiptar që ndodhi në gusht të vitit 1912. Unë besoj që edhe në këto vepra që po promovojmë sot, ka zënë vend figura e kolosit shqiptar Hasan Prishtina e që përkon me 100-vjetorin si kryeministër i 8-të i Shqipërisë, dhe sidomos lidhja e tij me Shkupin dhe përpjekja për ta shndërruar këtë qytet në piemont të shqiptarizmit. Historia jonë kombëtare po vazhdon të shkruhet, por fatkeqësisht ajo ende nuk është rrumbullakësuar si pasuri kombëtare, dhe për pasojë ka mbetur e pa plotë, prandaj do doja që pikërisht kjo konferencë shkencore dhe të tjera të ngjashme si kjo, të hapin udhën e një rishqyrtimi serioz të kësaj problematike, duke e ngritur edhe nivelin

e emrave që meritojnë në historiografinë tonë, siç është edhe prof. dr. Ramiz Abdyli.

ITShKSh me organizimin e konferencave të këtilla ka dëshmuar gjithnjë edhe më tepër si një adresë kredibile e motivit tonë shkencor për shumë çështje nga e kaluara e deri te e sotnja po e gjen trajtimin e duhur dhe kjo nuk mund të ndodhë pa përkushtimin serioz të drejtorit të këtij Instituti prof. dr. Skender Asani, angazhimi i të cilët është një model që duhet të shtrihet në mbarë hapsirën tonë etnike.

Uroj debat të frytshëm shkencor në këtë konferencë, kurse Profesorit tonë serioz Ramiz Abdyli i dëshiroj shëndet dhe shumë vepra të tjera nga korpusi i tij i pasur.

KUMTESAT E STUDIUESVE

MARENGLEN VERLI

Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë:

RAMIZ ABDYLI – PROFESORI DHE MIKU I NDERUAR

Prof. Ramiz Abdylit është një emër i njohur në historiografinë shqiptare. Falë punës së palodhur ai ia ka dalë të ketë një prodhimtari të dukshme shkencore, me botime të spikatura në gjini të ndryshme, si monografi, artikuj, kumtesa, dokumente etj. Ndër detyrat më me rëndësi që ka kryer, bën pjesë edhe drejtimi i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, me seli në Shkup, institucionit më prestigjioz të studiuesve albanologë në trevat shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Madje këtë detyrë e ka kryer në periudhën e startimit të punës së këtij institucioni, duke u angazhuar njëherësh në pozicionin e kryeredaktorit të revistës “Studime Albanologjike”, organit periodik të ITShKSh-së.

Shumëkush në rrethet e studiuesve të historisë e njeh punën e prof. R. Abdylit. Ai është një studiues me peshë në periudhën e historisë moderne të kombit shqiptar të shek. XIX–XX, por nuk ka nguruar të qaset edhe në tema e periudha që zbresin deri në shek. XV–XVI, duke i kushtuar vëmendje të veçantë historisë së trevave shqiptare lindore, që janë vise të vendlindjes së tij. Ndër botimet e prof. Abdylit mund të përmendim monografitë: “Gjendja dhe pozita e klasës punëtore në Kosovë (1918–1941)”, Prishtinë 1986; “Zef Lush Marku”, Prishtinë, 1988; “Lëvizja Kombëtare Shqiptare (1911–1912)”, Libri 1, 2, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë: KGT, 2004; “Hasan Jakup Ferri – një jetë për atdhe”, Shkup, 2019, etj.

Unë në këtë shkrim të shkurtër do të doja me tepër të portretojza profesor Ramizin jo si studiues, por si mik e bashkëpunëtor të vyer për rreth tri dekada.

Me profesorin jam njohur nga afër më 20–22 dhjetor 1991, në simpoziumin “Shqiptarët e Maqedonisë”, që u organizua në Shkup me nismën e Shoqatës së Arsimitarëve të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, të Meshihatit të Bashkësisë Islame të Maqedonisë, si dhe të Medresesë “Isa Beu”. Emrin e profesorit dhe punën e tij shkencore e njihja disi më herët, nga periudha e “mbylljes së madhe”. Madje pata botuar në vitin 1988 në revistën “Studime Historike” të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, edhe një recensë për një monografi të prof. Ramizit. Simpoziumi i Shkupit që një takim i paharuar i studiuesve nga të gjitha trevat shqiptare.

Gjatë viteve 80 takimet kishin qenë të pamundura, e aq më pak bashkëpunimet midis nesh, që do të duhej të kishin qenë të natyrshme. Kështu që Shkupi në dhjetorin e vitit 1991 mblodhi studiues nga Republika e Shqipërisë, nga Kosova, nga Maqedonia, nga Mali i Zi, dhe nga vise të tjera të ish-Jugosllavisë, madje edhe nga diaspora. Që njohje afatshkurtër e gjithkujt me shumëkënd, por për mua, në rastin e prof. Ramizit, qëlloi nga ato njohje që nuk shuhen, por shkojnë duke u forcuar.

Do të takoheshim sërish pas dy vjetësh me rastin e një simpoziumi tjetër. Këtë herë ai u mbajt në Tiranë, në datat 15–16 prill 1993, me temë “Çështja e Kosovës—një problem historik dhe aktual”. Dimensioni i veprimtarisë ishte përsëri gjithpërfshirës për studiuesit shqiptarë, madje në të pati pjesëmarrje edhe nga disa studiues të huaj nga Franca, Anglia etj. Në takimet jashtë sallës të simpoziumit bisedat me prof. Ramizin ishin vërtet të ngrohta, por edhe në foltoren e simpoziumit profesori dinte të ishte shumë njerëzor. Ai mbajti një temë për reformën agrare kolonizuese në Kosovë e në

viset e tjera shqiptare në Jugosllavi në periudhën midis dy luftërave botërore, për të cilën unë kisha realizuar disa publikime. Më ra në sy se profesori i nderuar më kish cituar e vlerësuar shumë në kumtesën e tij për angazhimin tim të deritanishëm rreth kësaj tematike. Ende sot nuk e di nëse prof. Ramizi kishte pasur në duar disa artikuj, që kisha botuar nga fundi i viteve 80 dhe kumtesën e mbajtur në dhjetor 1991 në Shkup, apo i kish rënë në dorë edhe monografia ime “Reforma agrare kolonizuese në Kosovë në vitet 1918–1941”, e cila ishte botuar një vit më parë (1992). Gjithsesi vlerësimi i tij më dha një kënaqësi të veçantë. Kështu, herë duke biseduar për punën e për projektet studimore e herë për tema të ndryshme të pafund, u bëmë të afërt me njëri tjetrin. Unë i dhurova me sa më kujtohet profesorit monografinë time, të vetmen të botuar si libër deri në atë kohë, e ai, e kujtoj si sot, më dhuroi një këllëf firmato për syzet, që e mbajta për shumë vjet si një kujtim të bukur.

Gjatë viteve 90 dhe në dy dekadat e fundit jam takuar shpesh me prof. Ramizin, herë në veprimtari shkencore e herë të tjera, kur kam udhëtuar në Prishtinë ose në Shkup për punë të ndryshme.

Dhe gjithherë, mund të pohoj për modestinë e profesorit në komunikim, por, ndoshta për këtë arsye, edhe hezitimin apo ndrojtjen e tij për të marrë përsipër angazhime, që i ofroheshin për ndonjë projekt të madh të iniciuar nga institucionet shkencore në Tiranë. Vura re me këtë rast besimin që kishin kolegët e tij në Institutin e Historisë së Akademisë së Shkencave për profesionalizmin dhe seriozitetin e tij. Veçanërisht të forta ishin lidhjet e bashkëpunimit dhe respekti reciprok midis prof. Ramizit dhe prof. Kristaq Priftit, drejtuesit kryesor të projektit “Historia e Popullit Shqiptar” në katër vëllime, që u botua në vitet 2003–2008. Vite më vonë kur prof. Prifti botoi monografinë “Popullsia e Kosovës (1831–1912)”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2014, prof. Ramizi i

bëri një recension analitik të mrekullueshëm, që e kënaqi shumë autorin, recension që u publikua menjëherë në revistën “Studime Historike”.

Së fundi profesor Ramiz Abdyli, që s’ka të ndalur në punën e tij shkencore, botoi monografinë “Hasan Feri–kreshniku i Çakorit”. Qysh kur e kishte në dorëshkrim ma vuri në dispozicion dhe më nderoi duke më propozuar recensionimin e kësaj vepre, ç’ka e pranova me kënaqësi. Më ka nderuar gjithashtu, duke më ftuar disa herë në veprintari të ndryshme këtu në Shkup. Kërkesa e prof. Skënder Asanit për të folur pak fjalë në këtë eveniment të bukur, organizuar për prof. Ramizin nga I.T.SH.K.SH, më nxiti për të formuluar shkurt, me pak fjalë, opinionin për mikun dhe profesorin e palodhur Ramiz Abdyli.

Duke përshëndetur organizatorët e kësaj veprintarie i uroj shëndet e punë të mbarë profesorit tonë të nderuar.

NAIM HALIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

KONTRIBUTI I PROF.DR RAMIZ ABDYLIT NË AVANCIMIN HISTORIOGRAFISË SHQIPTARE

Të flas për jetën dhe veprimtarinë e Prof.dr Ramiz Abdylit më nevojitet shumë kohë, meqë ai ka vepruar shumë dekada me plotë vepra të mira, për të cilat mund të flasim në shumë konferenca dhe libra, por ne në këtë rast do të rikujtojmë për një pjesë të veprimtarisë së tij. Kumesën e sotme e kam titulluar “Kontributi i Prof.dr Ramiz Abdylit në avancimin e historiografisë shqiptare, me rastin e 77 vjetorit të lindjes së tij”.

Treva shqiptare e Kumanovës ka dhënë shumë veprimtarë në mesin e të cilëve është edhe historiani i mirënjohur prof.dr Ramiz Abdyli.

Profesor Ramizin, siç e quajnë kumanovarët, lindi në vitin 1944 në Llojan, në një familje atdhetare. Mësimet e para i morri në vendlindje, Normalen dhe Fakultetin e Historisë i mbaroi në Shkup, magistraturën dhe doktoraturën i mbaroi në Prishtinë. Punoi në vendlindje, në Gjinnmazin e Kumanovës, në gazetën “Flaka e Vllazërimit” dhe Institutin e Historisë në Prishtinë, Institutin e Historisë Nacionale në Shkup, punoi në Universitetin e Tetovës dhe në ITShKSh. Pra, gjatë gjithë jetës punoi si profesor, gazetar, studiues, rektor, drejtor, puntor shquar shkencor, dijetar i matur dhe atdhetar.

Profesor Ramizi, të cilin kam pas rastin ta njoh edhe më herët qysh kur isha nxënës i tij, pastaj si student, koleg dhe bashkstudiuës,

pasion të madh e ka pasur punën, ndërsa një brengë që e ndrydh nga brenda edhe sot, është që të kontribuojë në çështjen kombëtare dhe në zgjedhjen e çështjes shqiptare, nga se i ndjen pushtimet dhe ripushtimet e hapësirave shqiptare dhe imponimet e sundimeve të huaja mbi ta, dhe ai nuk mund të mos i shifte si një nga burimet kryesore të padrejtësive, vrasjeve dhe shkatërrimeve në masë, shpërnguljet e gjenocideve në Kosovë, Kumanovë e Maqedoni e në viset tjera të shqiptarëve kudo që jetonin ato në ish Jugosllavi.

Profesor Ramizi qysh i ri i kuptoi mekanizmat e padrejtësive të pabarazisë dhe segregacionit etnik, dhe bashkë me brezin e intelektualëve të parë të kohës së tij kërkoi rrugë e punoi për kapërcimin e sfidave. Si intelektual dhe atdhetar që ishte, që në fillim kërkoi barazi shoqërore. Kjo frymë e re atdhedashurie do ta përcjell gjatë tërë jetës, ndërsa, këto çështje do t'i trajton përmes veprave shkencore të tij. Siç dihet, studimet e para profesor Ramizi do t'i nis në ngjarjet më të reja për ti hyrë gradualisht thellë në brendësi nga epoka e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, monografinë e të cilit i pari e pruri dhe e shpërndau në shkollën ku punoi në vitin 1968 në Kumanovë. Shkrimet e para i bëri me pjesëmarrjen e shqiptarëve në Luftën e Dytë Botërore, jo vetëm ndriçimin e rrethanave të asaj kohe, por edhe të orientimit të shqipëtarëve, të cilët që në ato kohëra kishin luftuar për të vu themelet e mëvetësisë kombëtare. Këto synime të profesorit shihen në botimet e para të tij deri në monografitë shkencore, me burime të marrura nga arkivat e vendeve të huaja, duke mos e anashkaluar as faktorin njeri.

Kontributi i Profesor Ramizit në shkencë shihet në veprat e botuara kryesisht në vitet e demokracisë, të “Lëvizja Kombëtare Shqiptare” pjesa e 1–2 e botuar në Prishtinë dhe në Shkup, dhe pastaj “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze” e botuar në

Prishtinë, dokumentet për luftën e Lëvizjes Kombëtare, dokumentet italiane për Kryengritjen e Përgjithshme dhe shumë botime dhe shkrime tjera, me qindra artikuj e studime materiale, recensione, polemika e kritika historiografike. Ishte pjesmarrës në shumë kongrese e simpoziume shkencore me karakter kombëtar e ndërkombëtar, disa prej të cilave janë botuar në revista të ndryshme shkencore dhe gazeta të vendit dhe të huaja si në: *Jehona*, *Përparimi*, *Glasnik*, *Kosova*, *Gjurmime Albanologjike*, *Kërkime Historike*, *Flaka e Vllazërimit*. Pa dyshim ato janë thesari i kësaj diturie, dhe këto të dhëna historike do t'i shërbejnë brezave dhe studiuesve të ardhshëm dhe historiografisë shqiptare.

Profesrin e gjejmë edhe si redaktor të disa botimeve monografike edhe në revista shkencore. Tërë këto vite ai ka qenë prezent edhe në njetet e informimit elektronike dhe të shkruara.

Profesor Ramiz Abdyli një kontribut të madhë e ka dhënë edhe për Historinë e Popullit Shqiptar në Maqedoni, në të cilën siç thot ai në shumë takime, biseda e konsultime, është pjesë e pandarë e historisë të Popullit Shqiptar.

Ai një studim të veçantë ia ka kushtuar edhe Shkupit si kryeqytet dardan, qyteti më i madh i banuar me shqipëtarë. I shkroi shumë artikuj e disa monografi Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për liri e pavarësi, sikurse edhe këto që po promovohen sot: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” dhe “Veprimtaria e Klubit Shqiptar të Shkupit” dhe shumë ngjarje e personalitete të tjera. Këto janë të dhëna arkivore e shkencore, me literature relevante bashkëkohore, materiale serioze të cilat në mënyrë shkencore i ka vërtetuar këto ngjarje në të cilët në zbraztirë të dhënave të këtij qyteti i hedh poshtë tendencat e mbrapshta të disa qendrave të historianëve pa marrë parasysh kush janë ato.

Nga kjo që u tha shkurt për profesor Ramiz Abdylin, mund të konstatojmë dhe mund të përfundojmë se ai i ka dhënë shumë historiografisë shqiptare, kontributi i të cilit ka merita të veçanta. Për meritat e jashtzakonëshme është shquar edhe nga institucionet ndërkombtare, si Instituti i Karolinës Veriore në vitin 1998, i cili e ka përzgjedhur ndër 500 personalitetet më të shquara. Idetë dhe veprat e këtij dijetari atdhetar kumanovar, studiusit dhe profesorit të klasës së parë i bënë nderë popullit shqiptar dhe shkencave humane dhe albanologjisë, në veçanti historisë së shqiptarëve në përgjithësi, dhe përcjellin mesazhe të mira në sajë të zhvillimeve kombëtare vendimtare për ardhmërinë e kombit tonë për zhvillimin e gjithëanshëm të tij dhe të botës shqiptare në përgjithësi.

Kjo veprimtari na shpie të kuptojmë dhe të studiojmë më lehtë rrugën e lirisë, pavarësisë së Kosovës avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni dhe të shqiptarëve në përgjithësi në territorret e tyre ku banojnë.

Faleminderit!

FEHARI RAMADANI

Universiteti "Fadil Sulejmani" në Tetovë

RAMIZ ABDYLI, PROFESORI QË MOTIVONTE

Takimin e parë me prof. dr. Ramiz Abdylin e kam realizuar në vjeshtën e vitit 2004, në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Atë vit Kuvendi i Maqedonisë miratoi Ligjin për njohjen (legalizimin e Universitetit të Tetovës) dhe Komisioni Amë, i formuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës bëri pranimin e kuadrit, i cili do të punonte në këtë institucion të arsimit të lartë në gjuhën shqipe. Në grupin e mësimdhënësve të pranuar ishim edhe profesori dhe unë. Ai në cilësinë e profesorit, kurse unë në atë të asistentit. Në mbledhjen e parë të katedrës Histori–Gjeografi, e takova për herë të parë edhe profesorin. Që herën e parë krijova bindjen se bëhet fjalë për një njeri të madh, pasi për cilësitë e tij në historiografi më kishin folur profesorët e mi në Tiranë.

Akademik Marenglen Verli, prof. dr. Ferit Duka dhe të tjerë, në vazhdimësi më kishin thënë se në Shkup jeton dhe punon njëri ndër njohësit më të mirë të historisë sonë kombëtare. Ata më këshilluan që ta takoja profesorin dhe më porositën që të mbaja kontakte të vazhdueshme, pasi nga ai do të mund të përfitoja shumë në aspektin profesional. Sigurisht se unë u kisha besuar profesorëve të mi, por njohja ime me profesor Ramizin më bëri të kuptoja se ai posedonte njohuri enciklopedike. Çdo temë që bisedonim nga historia jonë ai fliste me shumë kompetencë dhe me njohuri të detajuara.

Në vitet e para të punës sime në universitet, i mbaja ushtrimet në lëndën Historia e Popullit Shqiptar (1830–1912) dhe gjithashtu

mbaja ligjëratat në lëndën Historia e Bizantit, nën mbikëqyrjen e profesorit. Gjatë asaj periudhe kam pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm.

Në atë kohë, sapo e kisha përfunduar magistraturën dhe meqë u pranua në universitet më duhej të regjistroja edhe doktoratën. Në semestrin e dytë, të vitit akademik 2004/2005, profesori më pyet se ku planifikoja të regjistrohesha dhe çfarë teme do punoja. Sigurisht që nuk kisha dilemë për zgjedhjen e universitetit, pasi e kisha vendosur të vazhdoja në Tiranë, por, hamendësimi im ishte se çfarë teme të përzgjedh. Profesori më propozoi që të vazhdoja me periudhën e Rilindjes dhe gjithashtu më rekomandoi temën *“Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare (1900–1912)”*. Arsytimi i tij ishte se kur ai të pensionohej, unë do të duhej të vazhdoja ta ligjëroja lëndën e periudhës së Rilindjes, prandaj do të duhej që tema që do përzgjedhja t’i takonte kësaj periudhe. Gjithashtu, sipas profesorit tema që ai më rekomandoi ishte me shumë interes për historinë tonë kombëtare.

Sipas profesorit tri ishin arsye pse duhej të përcaktohesha për këtë temë:

- E para, në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë kishte njaft dokumente, të sjella nga arkivat e Vjenës dhe me hulumtimin e tyre do ta rrumbullaksoja temën;
- E dyta, tema nuk ishte shumë e hulumtuar nga historiografia shqiptare, deri në atë kohë, prandaj ajo do të përbënte kontribut të rëndësishëm për historiografinë tonë, dhe
- E treta, Austro-Hungaria kishte dhënë kontribut të rëndësishëm për çështjen shqiptare dhe hulumtimi i kësaj çështje nga studiuesit shqiptarë, do të ishte shenjë falënderimi për Vjenën.

Në fillim isha skeptik se do mund ta përfundoja tezën e disertacionit në këtë temë, duke u bazuar kryesisht në dokumente arkivore, pasi kisha frikë se nuk do gjeja dokumente të bollshme. Këtë ia kam thënë disa herë edhe profesorit, por ai arriti të më bind se jo vetëm që dokumentet do ishin të mjaftueshme por gjatë hulumtimeve të mia do të siguroja aq dokumente, sa që të gjitha nuk do të ishte e nevojshme t'i shfrytëzoja në temën e disertacionit, por ato do më shërbenin më vonë për punime shkencore. Gjithashtu, ai shprehu gatishmërinë e tij për të qenë udhëheqësi im shkencor (mentori).

Kërkesa ime për të vazhduar studimet e doktoratës me temën e sipërpërmendur dhe nën udhëheqjen shkencore të profesorit, u miratua nga Departamenti i Historisë në Universitetin e Tiranës, më 16 janar 2006.

Gjithashtu bashkë me profesorin kam qenë në hulumtime, në Arkivin e Institutit të Historisë, në Bibliotekën e Institutit, si dhe në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Kudo që shkonim takohej me studiues të shquar, si: Akademik Kristaq Prifti, Akademik Marenglen Verli, Akademik Beqir Meta, Prof. dr. Gazmend Shpuza, Prof. dr. Xhelal Gjeçovi, Prof. dr. Xhevat Lloshi etj. Secili prej tyre shprehte respekt të veçantë për profesorin, si njohës të shkëlqyeshëm të historisë sonë kombëtare.

Në janarit e vitit 2006, gjatë kohës kur ishim në hulumtime profesori më takoi me Prof. dr. Hysni Myzirin, njohësin e shkëlqyeshëm të historisë së arsimit dhe të kulturës shqiptare. Meqë tema ime e disertacionit i takonte fushës së arsimit dhe të kulturës, profesori vlerësoi se takimi im me profesor Hysniun do të më ndihmonte për ta pasuruar literaturën e nevojshme për temën time. Kështu edhe ndodhi. Nga ky takim arrita të siguroj disa artikuj shkencorë, për të cilët deri atëherë nuk kisha njohuri (4 artikuj të studiuesit

Zija Prela, të cilët trajtonin politikën e Austro-Hungarisë në Shqipëri dhe që më ndihmuan shumë në përfundimin e temës sime).

Profesor Ramizi në vazhdimësi më motivonte që të punoja me zell, si me studentët ashtu dhe në përgatitjen dhe botimin e artikujve shkencorë. Një pjesë të mirë të literaturës, të gazetave për përgatitjen e tezës së disertacionit dhe të punimeve ma siguronte vet profesori nga biblioteka e tij shumë e pasur.

Gjatë punës sime, si në përgatitjen e artikujve shkencorë ashtu edhe në tezën e doktoratës, kam fituar përvojë të mirë nga profesori. Meqë e kisha udhëheqës shkencor dhe njëkohësisht punonim në të njëjtën katedër kam mësuar shumë nga ai. Por, një gjë që më ka mbetë pashlyeshme në memorien time është se ai në vazhdimësi më thoshte: *“kur të shkruash gjithmonë duhet ta kesh parasysh titullin e punimit. Kurrë mos dil nga tema të cilën e trajton”*. Kjo këshillë e profesorit ishte mjaft e rëndësishme, pasi në atë kohë më ndodhte shpesh që të largohesha nga tema të cilën e trajtoja, duke u zgjeruar edhe në çështje të cilat nuk lidheshin drejtpërdrejt me temën.

Në kohën kur isha duke grumbulluar materialet për temën e doktoratës, si literaturën dhe dokumentet arkivore, përgatita një artikull shkencor për botim. Para se ta dërgoja për botim, ia dhashë profesorit ta kontrollonte. Pas disa ditësh ma ktheu punim dhe kur e hapa pashë që në secilin paragraf kishte ndërhyrë, duke shënuar këshilla, plotësime ose kishte pjesë të cilat i kishte fshirë. Pasi i bëra korrigjimet e nevojshme ia dhashë përsëri ta lexonte dhe përsëri kishte gjetur lëshime. Vetëm herën e tretë ma dha lejen ta dërgoja për botim. Sigurisht atëherë nuk është se më pëlqeu shumë korrigjimi, por më vonë këshillat e tij më kanë shërbyer në punën time profesionale.

Përvoja ime e bashkëpunimit me prof. Ramiz Abdylin dëshmon se ai i ngjan kapitenit të anijes me të cilën udhëtoni bashkërisht, por kurrë nuk të le vetëm që të mbytesh. Bashkëpunimi me atë të jep siguri sepse ai të udhëzon drejt për të arritur qëllimin e synuar. Ai është njeriu i cili të këshillon, të udhëzon, të orienton dhe të udhëheq drejt qëllimit të cilin ia ke vënë vetes.

Ju faleminderit profesor për gjithçka që keni bërë për mua, për studentët e katedrës së historisë në Universitetin e Tetovës dhe për historiografinë shqiptare. Uroj të keni shëndet dhe vepra të reja!

QERIM DALIPI

Universiteti “Fadil Sulejmani” në Tetovë

RAMIZ ABDYLI DHE KONTRIBUTI I TIJ NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE (DERI NË PRAG TË LIDHJES SË PRIZRENIT)

Gjatë vitit të fundit të studimeve (1993–1994), nga kolegët e mi mësova se prof. dr. Ramiz Abdyli, që kishte punuar për disa vite në Institutin e Historisë në Prishtinë, ishte punësuar në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup dhe kishte si objektiv krijimin e sektorit për historinë shqiptare në kuadër të këtij institucioni shkencor. Në të duhej të punësoheshin kuadro të reja, shtetas të Maqedonisë së Veriut, që kishin treguar rezultate të larta gjatë studimeve dhe njëkohësisht do të vazhdonin studimet e magjistraturës. Me preferencë të Ramiz Abdylit, të cilin nuk e njihja, më kontaktoi disa herë përmes telefonit prof. dr. Emine Bakalli, e cila, pasi që isha nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe isha dalluar në studime, më njoftoi për mundësinë e hapjes së sektorit të përmendur dhe mundësinë e punësimit aty pasi t'i përfundoja studimet.

Aty nga fundi i vitit 1994, pasi diplomova, kompletova dokumentacionin dhe, në janar të vitit 1995, në bazë të konkursit të shpallur aplikova për vendin e punës “Asistent i ri” në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup. Ky qe rasti i parë kur edhe u njoha nga afër me profesorin, i cili me urtësinë dhe modestinë e tij më la përshtypje shumë pozitive. Lidhur me mundësinë e vazhdimit të studimeve të magjistraturës, ai pasi sqaroi rëndësinë e periudhës së mesjetës për historinë shqiptare, më sugjeroi që të regjistroja

pikërisht këtë periudhë. Edhe pse deri në atë moment kisha preferuar të vazhdoja studimet në periudhën e antikës, vendosa të veproj sipas sugjerimeve të profesorit.

Në Institut nuk u pranova, sepse atëbotë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk njiheshin diplomat nga Republika e Kosovës. Profesori bëri edhe disa përpjekje të tjera rreth punësimit tim, por nuk ia doli. Megjithatë, kontaktet tona vazhduan. Unë regjistrova studimet e magistraturës në Prishtinë dhe me rastin e përgatitjes së dy punimeve seminarike gjeta mbështetjen e profesorit, i cili më huazoi burime dhe literaturë relevante nga biblioteka shumë e pasur e Institutit.

Në vitin 1998 u punësova në Universitetin e Tetovës, aty ku ishte i angazhuar edhe profesor Ramizi, njëri nga themeluesit e këtij Universiteti. Me këtë, vazhduam t'i mbanim kontaktet dhe bashkëpunimin. Në këtë drejtim, gjatë vitit 1999, kur unë isha duke përgatitur punimin e magistraturës, bashkë me profesorin, qëndruam dy herë për hulumtime kërkimore—shkencore në arkivin dhe bibliotekën e Institutit të Historisë dhe në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Kjo për mua, si i ri dhe pa përvojë që isha, ishte një mbështetje e madhe për t'i përballuar sfidat e hulumtimit kërkimor—shkencor, dhe falë autoritetit të tij dyert e këtyre institucioneve i kisha të hapura. Pas disa vitesh, në kohën kur unë përgatitja disertacionin e doktoratës dhe profesorin e kisha mentor, gjatë viteve 2006–2008, puna e deshi të qëndronim dy—tri herë për hulumtime në Tiranë dhe një herë në Sofje të Bullgarisë. Gjatë kohës së lirë bisedonim për probleme të ndryshme të historiografisë shqiptare dhe emërues i përbashkët i qëndrimeve të tij ishte se historia ishte e vështirë për t'u shkruar, dhe për të arritur deri te e vërteta historike duhej të ballafaqoheshin të dhënat e proveniencave të ndryshme.

Gjatë viteve 2006–2009, kur unë ligjëroja lëndët përkatëse në cilësinë e “ligjëruesit me mbulesë”, me nënshkrimin e tij më mbulonte pikërisht Prof. dr. Ramiz Abdyli, nga përvoja akademike e të cilit mësova shumë. Më shumë se kaq, pata nderin që atë ta kem recensent në njërin nga librat e mi, si dhe kryetar të komisionit recensues në avancimet e mia nga docent deri në profesor ordinar.

Prof. dr. Ramiz Abdylin e mbaj mend se qe iniciator për t’u formuar një ekip studiuesish shqiptarë, i cili, me mbështetje financiare nga faktori politik shqiptar, pjesëmarrës në qeveri, do të fillonte punën për hartimin e *Historisë së shqiptarëve në Maqedoni*. Por, meqë nuk gjeti mbështetje, ky projekt pret për t’u realizuar në një moment të përshtatshëm.

Ajo që i spikat njerëzit e mëdhenj të shkencës janë të arriturat shkencore dhe modestia e tyre, të cilat i gjejmë edhe te personaliteti krijues i profesor Ramizit. Si studiues me bagazh të madh shkencor, ai gjithmonë i respekton mendimet e studiuesve të tjerë dhe nuk heziton të marrë në konsideratë edhe mendimet e studiuesve më të rinj. Në rrethana të këtilla, vazhdon bashkëpunimi shkencor midis nesh.

Gjatë njohjes dhe bashkëpunimit tonë mbi 25–vjeçar, natyrisht se midis nesh ka pasur edhe momente mospajtimi për çështje shkencore dhe akademike, por ato janë tejkaluar dhe kanë mbisunduar vlerat pozitive për çështjet në fjalë.

Pavarësisht se shumëçka nuk është përmendur, si më sipër, prof. Ramizin e përgëzoj për kontributin që ka dhënë për brumosjen me dije të studentëve në ciklin I të studimeve dhe për ngritjen shkencore dhe akademike të studentëve të magistraturës dhe të doktoratës, si dhe për kontributin që vazhdon të japë me prurjet e tij për historiografinë shqiptare. Njëherësh, i dëshiroj të ketë jetë të gjatë e të begatë me plot prurje të reja shkencore.

Duke marrë për bazë bibliografinë shumë të pasur studimore, jeta dhe vepra shkencore e studiuesit Ramiz Abdyli ka zënë vend në *Fjalorin enciklopedik shqiptar*,¹ *Fjalorin enciklopedik të Kosovës*² dhe në *Enciklopedinë maqedonase (Македонска енциклопедија)*³, por kjo e fundit për shkak të disa zërave antishqiptar dhe antiamerikan, është tërhequr nga përdorimi.

Përkundër faktit se veprimtaria shkencore e Prof. dr. Ramiz Abdylit kryesisht lidhet me fundshekullin XIX dhe shekullin XX, ai ka dhënë kontribut të rëndësishëm edhe për periudhën para Lidhjes së Prizrenit. Kështu, Ramiz Abdyli është autor i 20 zërave në “*Fjalor enciklopedik i Kosovës*” për periudhën e mesjetës: *Adae Guillelmus*, *Antolak Stjepan*, *avarët*, *beteja e Maricës*, *beteja e Nikopolit*, *beteja e Varnës*, *Bizanti*, *Buda Aleks*, *çerkezët*, *Diniq Mihajlo*, *Dukas*, *dyndjet bullgare*, *dyndjet kumane*, *feudalizmi*, *Gregora Nikifor*, *Honiati Nikita*, *Jireçek Konstandin*, *kodi i Dushanit*, *Komnena*⁴ dhe *Ruvarac Ilarion*.⁵

Punimi voluminoz “*Qëmtime mbi shqiptarësinë e Shkupit gjatë pushtimit osman*” i botuar në dy vazhdimë në revistën shkencore “*Kosova*” të Institutit të Historisë në Prishtinë, përbën një kontribut të rëndësishëm për historinë më se pesëshekullore të këtij qyteti. Autori, i mbështetur në rezultatet shkencore të studiuesve me emër, sjellë prova se atdheu ballkanik i shqiptarëve është Dardania, kurse nga kryeqyteti i saj, Shkupi, vjen emri shqiptar. Më pas hidhet dritë mbi rënien e këtij qyteti nën sundimin osman dhe shndërrimin e tij në qendër të rëndësishme politike të shtetit osman,

¹ *Abdyli Ramiz*, në: “Fjalor enciklopedik shqiptar”, 1, Tiranë, 2008, 5.

² *Abdyli Ramiz*, në: “Fjalor enciklopedik i Kosovës, I (A-K), Prishtinë, 2018, 4.

³ *Абдили Рамиз*, në: “Македонска енциклопедија, I: A-Љ, Скопје, 2009, 3.

⁴ *Fjalor enciklopedik i Kosovës*, I (A-K), 6-7, 54, 82-83, 179, 180, 182, 197-198, 226, 275, 331, 361, 370-371, 446, 523-524, 627, 718, 810, 828.

⁵ *Fjalor enciklopedik i Kosovës*, II (L-Zh), Prishtinë, 2018, 1451.

prej nga ndërmerreshin ekspedita pushtuese osmane ndaj viseve fqinje. Në vazhdim, vend i rëndësishëm i kushtohet çështjes së asimilimit të shqiptarëve të krishterë në myslimanë, shumica e të cilëve ruajtën gjuhën dhe doket e zakonet e tyre tradicionale. Kështu, shqiptarët e krahinës së Shkupit nuk merrnin si më parë emra sllavë,⁶ por emra orientale–islamë.

Ndonëse Shkupi nuk hyri në kuadër të shtetit të Skënderbeut, studiuesi i përmendur supozon se kufijtë e tij shkonin shumë afër në rrethinën e këtij qyteti. Këtë e mbështet në dy betejat që i zhvilloi Skënderbeu në krye të ushtrisë së tij kundër osmanëve, jo larg Shkupit, në përfundim të tij, diku në derdhjen e lumit Treskë në Vardar, apo në fshatrat shqiptare pak më në veriperëndim të këtij lumi.⁷

Meqë popullsia në Perandorinë Osmane evidentohet sipas përkatësisë fetare, studiuesit e kanë njafat të vështirë që të japin një pasqyrë të saktë të strukturës etnike të kësaj popullsie. Pavarësisht kësaj, studiuesi Ramiz Abdyli, duke u mbështetur në burime relevante të kohës dhe në rezultatet e studiuesve respektivë, sjellë prova se Shkupi dhe rrethina e tij gjatë sundimit osmanë banoheshin me shumicë shqiptare.⁸

Vend të rëndësishëm autori u kushton luftërave austro–osmane të fundshekullit XVII dhe fillimit të shekullit XVIII. Kështu, ai trajton përfshirjen e shqiptarëve me në krye argjipeshkvën e Shkupit, Pjetër Bogdani, në radhët e ushtrisë austriake në luftë kundër osmanëve (1689–1690), si dhe hedhë dritë për kryengritjen kundërosmane gjatë luftës austro–turke të viteve 1737–1739, ku një rol të rëndësishëm luajti argjipeshkvë i Shkupit, Mikel Summa.

⁶ Ramiz Abdyli, *Qëmtime mbi shqiptarësinë e Shkupit gjatë pushtimit osman*, në: “Kosova”, nr. 28, Prishtinë, 2006, 101–105.

⁷ *Po aty*, 105.

⁸ *Po aty*, 107–119; *Qëmtime mbi shqiptarësinë e Shkupit gjatë pushtimit osman*, (vijon nga numri i kaluar), në: “Kosova”, nr. 29–30, Prishtinë, 2008, 89–113.

Më pas, autori, i mbështetur në argumente shkencore, nxjerrë në pah se e ashtuquajtura “shpërngulje e madhe serbe” nga Kosova dhe nga Maqedonia (sot: Maqedonia e Veriut – Q. D.) pas përfundimit të luftërave të sipërpërmendura dhe “popullimi” i tyre me shqiptarë, është një sajësë e historiografisë serbe. Rrjedhimisht, ai konstaton se shqiptarët në Kosovë dhe në viset shqiptare të Maqedonisë e të Luginës së Preshevës kanë qenë ndër shekuj autoktonë dhe jo të ardhur pas luftërave të përmendura më sipër.⁹

E një rëndësie të veçantë për krahinën e Shkupit ishte gjysma e dytë e shek. XVIII dhe tre dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XIX, kur u ngrit dhe u fuqizua Pashallëku i Shkodrës. Mbi bazën e një dhëne të vitit 1772, ku thuhet se “Mehmet Pasha u bë aq i fuqishëm sa që prej kufijve venedikas deri në Manastir komandon absolutisht dhe e druajnë të gjithë”, studiuesi Ramiz Abdyli me të drejtë konstaton se edhe Shkupi përfshihej brenda kufijve të këtij pashallëku “gjysmë të pavarur”. Rrjedhimisht, autori vë në pah edhe rëndësinë ekonomike që fitoi Shkupi gjatë sundimit të pashallarëve shkodranë, si dhe rëndësinë politike, meqë pikërisht në këtë qytet pashallarët shqiptarë, më 1831 hartuan planin e luftës kundër Perandorisë Osmane.¹⁰

Midis shumë prurjeve të tjera që lidhen me Shkupin dhe rrethinën e tij, mund të veçohen edhe ato për kryengritjen kundër-osmane me në krye Dervish Carën (1843–1844), e cila shpërtheu në Shkup dhe u përhap në vise të tjera lindore dhe verilindore shqiptare, kurse kërkesë kryesore e kryengritësve shqiptarë ishte autonomia e Shqipërisë.¹¹

⁹ Ramiz Abdyli, *Qëmtime mbi shqiptarësinë e Shkupit gjatë pushtimit osman*, në: “Kosova”, nr. 28, 121-124.

¹⁰ *Po aty*, 124-127.

¹¹ *Qëmtime mbi shqiptarësinë e Shkupit gjatë pushtimit osman*, në: “Kosova”, nr. 29-30, 90-92.

Profesor Ramiz Abdyli mori pjesë në simpoziume dhe konferenca shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërsa punimet e tij u botuan në përmbledhjet e veçanta të këtyre evenimenteve. Në këtë kuadër dallohet punimi studimor “*Shqiptarët e Maqedonisë sipas të dhënave të defterëve osmanë të shek. XV–XVI*”. Në këtë punim, autori fillimisht vë në pah se nga të dhënat antroponomike dhe toponomastike të nxjerra nga defterët e hollësishëm rezulton se shqiptarët, gjatë shek. XV–XVI, ishin të pranishëm në krahinat e Shkupit, të Tetovës, të Gostivarit, të Kërçovës, të Dibrës, të Strugës, të Velesit etj. Shqiptarët banonin edhe më në lindje, juglindje dhe verilindje të këtyre viseve. Rrjedhimisht, një kategori e banorëve mbante emra që ishin karakteristike për shqiptarët. Banorë të tjerë, mbanin emra ortodoksë sllavë, bizantinë dhe myslimanë. Emrat ortodoksë sllavë dhe ata bizantinë përdorshin si nga popullsia shqiptare, ashtu edhe nga ajo sllave. Ishte i pranishëm edhe përdorimi i apelativit (*Arbanas/Arvanid/Arnaut*) në vend të mbiemrit, kurse antroponimia e fesë katolike hasej shumë rrallë. Në vazhdim, autori e mbështet autoktoninë e shqiptarëve në trojet lindore përmes dëshmive toponomastike, dhe hedhë dritë edhe për fillimet e islamizimit të tyre.¹²

Punimi tjetër studimor titullohet “*Skënderbeu sipas Gjorgji Pulevskit*”. Në këtë punim, studiuesi Ramiz Abdyli, fillimisht vë në pah se sipas historianit të parë maqedonas, Gjorgji Pulevski, kufiri midis Shqipërisë dhe Maqedonisë nga veriu fillonte te Katllanova, midis Shkupit dhe Velesit, për të vazhduar në jug në lindje të Makedonski Brodit, të Kërçovës e të Demir Hisarit dhe më tej shkonte ndërmjet Manastirit e Prespës drejt malit Pelister, në jug të

¹² Ramiz Abdyli, *Shqiptarët e Maqedonisë sipas të dhënave të defterëve osmanë të shek. XV–XVI*, në “Shqiptarët e Maqedonisë”, Simpozium, Shkup, 20-22 dhjetor 1991, Shkup, 1994, 133-144.

Manastirit, për të vazhduar më tej në Greqi. Më pas autori e vë theksin mbi ngjarjet më të rëndësishme për Skënderbeun që Gjeorgji Puleski i ka trajtuar në veprën e tij. Kështu, midis tjerash, nxirren në pah njoftimet se si princi serb Gjurgj Brankoviqi nuk e kishte lejuar Skënderbeun të kalonte nëpër tokat e tij për të ndihmuar Janosh Huniadin në Betejën e Varnës (1444). Në vijim zënë vend njoftimet lidhur me luftën e Skënderbeut kundër ushtrive osmane, udhëtimin e tij në Romë te papa për t'i kërkuar atij ndihmë dhe kthimin në atdhe. Të rëndësishme janë edhe njoftimet për pushtimet osmane në Shqipëri pas vdekjes së Skënderbeut dhe vlerësimet reale që i janë bërë heroit shqiptar nga Pulevski.¹³

Marrë në tërësi, punimet e Prof. dr. Ramiz Abdylit, janë shkruar me një stil gjuhësor të lartë e të kuptueshëm, që spikasin për nga thellësia e trajtimit të problemeve, ndërsa rezultatet e arritura mund t'i bëjnë ballë kritikës shkencore.

Përfundimi

Prof. dr. Ramiz Abdylit, u punësua në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup dhe si objektiv kishte krijimin e sektorit për historinë shqiptare në kuadër të këtij institucioni shkencor. Ai ndikoi që unë të vazhdoja studimet e magistraturës në periudhën e mesjetës dhe më mbështeti e më dha këshilla profesionale lidhur me sfidat e hulumtimit kërkimor–shkencor. Po ashtu, mësova shumë nga përvoja e tij akademike dhe mora mbështetjen e tij në avancimin tim profesional–shkencor. Veç kësaj, prof. dr. Ramiz Abdylit ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut të rëndësishëm me prurjet

¹³ Ramiz Abdylit, *Skënderbeu sipas Gjorgji Pulevskit*, në “Skënderbeu dhe Evropa”, Konferenca shkencore ndërkombëtare, me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, Tiranë, 9-10 dhjetor 2005, Tiranë, 2006, 377-384.

e tij shkencore për historiografinë shqiptare. Në këtë kuadër, ai ka shkruar edhe për periudhën para Lidhjes së Prizrenit, duke qenë autor i disa zërave enciklopedikë për periudhën e mesjetës dhe autor i disa punimeve studimore, disa nga të cilët u prezantuan në konferenca shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtare.

ISAMEDIN AZIZI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

KONTRIBUTI SHKENCOR I PROF. RAMIZ ABDYELIT NË INSTITUTIN E HISTORISË NACIONALE –SHKUP

Është privilegj dhe nder i veçantë që të marrësh pjesë në një konferencë shkencore që i dedikohet profesorit të respektuar Ramiz Abdylit. Nderi është edhe më i madh kur kësaj i shtohet edhe fakti se unë për disa vjet kam qenë edhe asistent i tij në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup.

Për prof. Abdylin, i cili mbi supe bart një bagazh të pasur shkencor dhe një punë të palodhshme e të gjatë, mund të thuhet e të shkruhet shumë. Për këtë kumtesë unë jam përcaktuar për aktivitetin shkencor të prof. Abdylit në Institutin e Historisë Nacionale dhe arsyeja për këtë është fakti se edhe vet kam qenë i punësuar një kohë të gjatë në atë institut, dhe se “zanatin” e shkencës apo thënë ndryshe “abetaren” e shkencës e kam mësuar pikërisht nga prof. Abdylit.

Prof. Abdylit pas një pune të gjatë në Kosovë në vitin 1994 fillon me punë në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup, si këshilltar shkencor. Instituti i Historisë Nacionale i cili është instituti më i vjetër shkencor në Maqedoni, i themeluar në vitin 1949, në njëfarë mënyre ka qenë i pakapshëm për shqiptarët. Se sa i pakapshëm për shqiptarët ka qenë Instituti i Historisë Nacionale tregon fakti se deri para se të punësohet prof. Abdylit, pra deri në kohën e pluralizmit, në këtë institut, i vetmi studiues shqiptar i

punësuar ka qenë profesori Masar Kodra, i cili këtu punoi vetëm tetë vjet për të vazhduar pastaj me punë në Prishtinë.

Për kohën s ka punuar në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup, rreth 11 vjet, prof. Abdyli ka dhënë një kontribut të madh në sferën shkencore. Punimet e tij janë të botuara në dy revistat shkencore: në revistën shkencore “Glasnik”, të botuar nga ky institut, dhe në revistën shkencore “Historia”, të botuar nga Shoqata e Historianëve të Maqedonisë. Një kontribut të veçantë shënon edhe libri i prof. Abdylit në dy vëllime i botuar nga Instituti i Historisë Nacionale.

Sipas sasisë, botimet shkencore të prof. Ramiz Abdylit janë shumë më të vëllimshme në gjuhën shqipe se sa botimet e prurjet e tij në gjuhën maqedonase. Por për nga vlera, në kuptimin e afirmimit të historisë shqiptare, për mendimin tim, punimet në gjuhën maqedonase kanë një peshë të veçantë. Duke pasur parasysh faktin se ky institut ka qenë i pakapshëm për shqiptarët për një kohë të gjatë, dhe duke pasur parasysh politikën shtetërore të asaj kohë ndaj shqiptarëve, shkrimet e historianëve shqiptarë në gjuhën maqedonase kanë pasur një rëndësi të madhe në mesin e historianëve maqedonas meqë ato i kanë informuar lexuesit maqedonas dhe njëkohësisht edhe historianët maqedonas për historinë e shqiptarëve në përgjithësi e për historinë e shqiptarëve të Maqedonisë në veçanti. Ndoshta një krahasim i këtillë ndërmjet lexuesve maqedonas dhe historianëve maqedonas për historinë e shqiptarëve është jo i drejtë, por duke u bazuar në përvojën time shumëvjeçare në Institutin e Historisë Nacionale dhe kontaktet dhe diskutimet që i kam pasur me kolegë maqedonas në këtë temë, kam përshtypjen se nuk ekziston ndonjë dallim i madh ndërmjet lexuesve maqedonas nga njëra anë, dhe studiuesve maqedonas nga ana tjetër. Ata fare pak, për mos të thënë aspak nuk kanë njohuri për historinë tonë. Mosnjohja e

gjuhës shqipe, por mbi gjitha mosinteresimi i tyre për historinë tonë, ka bërë që ata edhe për ato pak shkrime që shkruhen prej studiuesve shqiptarë në revista në gjuhën maqedonase të kenë rezerva për botimin e tyre.

Për mendimin tim një punim i botuar në një gjuhë të huaj, qoftë edhe në maqedonisht, ka peshë shumë më të madhe dhe jep kontribut shumë më të madh në afirmimin e historiografisë shqiptare karshi të tjerëve, karshi jo shqiptarëve, sesa punimet në gjuhën shqipe. E këtë e ka bërë prof. Ramiz Abdyli me punimet e botimet e veta në gjuhën maqedonase.

Në revistën shkencore “Historia” punimi shkencor i Ramiz Abdyli ka të bëjë me jetën dhe veprimtarinë e Zef Lush Markut, një emër shumë i njohur për Shkupin por i panjohur për aktivitetin e tij. Me punimin e tij shkencor në këtë revistë shkencore me titull “Zef Lush Marku – një përkrahës i shquar i klasës punëtore në Maqedoni dhe në Kosovë (1885–1920), Prof. Ramiz Abdyli lexuesit maqedonas ia prezanton këtë figurë të rëndësishme i cili një pjesë të jetës së tij e kishte kaluar në Shkup, ku kishte vazhduar aktivitetin e tij politik, aktivitet që e kishte filluar në Kosovë. Në këtë punim prof. Abdyli figurën e Zef Lush Markut na e paraqet në dy dimensione; në atë familjar, ku jepen të dhëna interesante për jetën e tij dhe të familjes së tij në Kosovë, dhe në dimensionin politik ku përshkruhet i gjithë aktiviteti i tij politik, qoftë në Kosovë, qoftë në Maqedoni deri në vrasjen e tij në vitin 1920.

Dy punime njafte interesante të prof. Ramiz Abdyli në bashkautorësi me Muzafer Bislimin në gjuhën maqedonase janë të botuara në dy numrat e revistës shkencore “Glasnik” të Institutit të Historisë Nacionale në Shkup në vitin 2002 dhe 2003. Në këto punime botohen raportet e konsujve austro–hungarez nga Maqedonia për klubet shqiptare në Maqedoni në vitin 1908, gjegjësisht në

vitet 1909–1910. Në revistën shkencore “Glasnik” të vitit 2002 janë botuar nëntë dokumente austro–hungareze me titull “Raportet e konsujve austro–hungarez nga Maqedonia për veprimtarinë e klubeve shqiptare në Maqedoni”. Dokumentet në fjalë që dalin nga zyrat e konsujve në Shkup, Manastir dhe Selanik, janë të dedikuara për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro–Hungarisë, baronin Erental, si dhe për ambasadorin në Stamboll z. Pllavacini. Raportet flasin për situatën politike në këto pjesë të Perandorinë Osmane pas Revolucionit xhonturk dhe për vendosjen e kushtetutës, flasin për formimin e klubeve shqiptare dhe veprimtarinë e tyre. Rëndësi të veçantë këto raporte i kushtojnë qëndrimin të xhonturqve rreth themelimit të shkollave shqipe dhe rreth përdorimit të gjuhës dhe alfabetit shqip. Nga këto raporte arrijmë ta kuptojmë qëndrimin e xhonturqve në raport me klubet shqiptare, e sidomos ndryshimin e qëndrimit të tyre pas miratimit të alfabetit latin në Kongresin e Manastirit.

Në po të njëjtën revistë, atë të “Glasnikut” një vit më vonë, në vitin 2003, Ramiz Abdyli në bashkautorësi me Muzafer Bislimin botojnë edhe tri dokumente të tjera njaft të rëndësishme me titull “Raportet e konsujve austro–hungarez në Shkup për aktivitetin e klubit shqiptar Bashkimi dhe për formën e alfabetit shqip në vitin 1909 dhe 1910”. Në këto raporte flitet për aktivitetin e klubit shqiptar nga Shkupi “Bashkimi” i formuar në vitin 1908 me iniciativën e veprimtarëve të shquar shqiptarë: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Bedri Pejani, Nexhip Draga, Sait Hoxha etj. Nga këto dokumente kuptojmë që në themelimin e këtij klubi rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe vëllezërit Çerçiz dhe Bajo Topulli si dhe Shahin Kolonja. Qëllimi kryesor i këtij klubi ka qenë organizimi i kurseve për njohjen e shkrimit të gjuhës shqipe. Klubi Bashkimi arriti që të

botojë gazetën e vet me po të njëjtin emër në gjuhën shqipe dhe atë turke.

Botimi në dy vëllime në gjuhën maqedonase i monografisë “Lëvizja kombëtare shqiptare 1908–1910 dhe 1911–1912” paraqet kulmin e punës së tij shkencore në këtë institut. Botimi i kësaj monografie paraqet kurorëzimin e një pune disavjeçare hulumtuese–shkencore të Ramiz Abdylit i cili ka arritur që në mënyrë të shkëlqyer t’ua paraqesë lexuesve dhe studiuesve maqedonas zhvillimet e ngjarjeve historike të shqiptarëve të periudhës më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar.

Ajo që e madhështon edhe më shumë këtë monografi është fakti se për botimin e këtij libri janë përdorur shumë dokumente nga shumë gjuhë: angleze, franceze, osmane, bullgare, serbe e shqiptare. Libri me mbi 1000 faqe, i ndarë në dy vëllime, me shumë kapituj e nënkapituj, është i pasuruar edhe me hyrje, përfundim, bibliografi si dhe me indeksin e emrave personalë dhe gjeografikë.

Vëllimi i parë i përbërë nga 4 kapituj e 37 nëntituj, përfshin periudhën nga viti 1908 e deri në vitin 1910. Ashtu siç mund të shihet edhe nga vet titulli i librit, në këtë pjesë përshkruhet procesi i gjatë i luftës së popullit shqiptar për pavarësi. Për këtë periudhë vlen të përmenden disa ngjarje të rëndësishme historike, ndër të cilat mbajtja e Kongresit të Manastirit dhe roli i klubeve shqiptare në këtë kohë, përfshirja e shqiptarëve në Revolucionin xhonturk dhe mosmarrëveshjet me ta, ndërsa fokusi kryesor i vëllimit të parë është përqendruar në kryengritjen e shqiptarëve në Vilajetin e Kosovës kundër Perandorisë Osmane në vitin 1910, me theks të veçantë në aktivitetet luftarake në Sanxhakun e Prishtinës dhe të Pejës, për të vazhduar tutje me betejën në Grykën e Kaçanikut.

Vëllimi i dytë i përbërë nga 2 kapituj e 22 nëntituj, përmbledh ngjarjet e hapësirës kohore të vitit 1911–1912. Këtë pjesë autori e

nis me ekspeditën ndëshkuese të Shefqet Turgut Pashës dhe me largimin e forcave kryengritëse në Mal të Zi për të vazhduar më pastaj me përgatitjet për fillimin e një kryengritjeje të re. Më tej autori na flet edhe për vazhdimin e aktiviteteve politike të kryengritësve shqiptarë në këtë periudhë, duke filluar me Kuvendin e Greçës ku rëndësi të veçantë i kushton Memorandumit të këtij kuvendi, e për të vazhduar më tej me kryengritjen e vitit 1911 dhe duke e përmbyllur me kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912.

Atë që do ta kisha veçuar nga kjo monografi e botuar në gjuhën maqedonase është përshkrimi i disa ngjarjeve historike të ndërlidhura me shqiptarët e Maqedonisë, të cilat ngjarje pothuajse asnjëherë nuk gjetën vend në historiografinë maqedonase, edhe pse ishin të një peshe jashtëzakonisht të madhe për shqiptarët, siç është rasti me Kongresin e Manastirit e sidomos me hyrjen apo çlirimin e Shkupit më 12 gusht të vitit 1912 nga kryengritësit shqiptarë. Profesor Abdyli me përshkrimin e këtyre dy ngjarjeve e theu tabunë karshi studiuesve maqedonas për këto tema. Asnjë studiues maqedonas nuk është marrë me këto tema. Para dy vjetësh, në institutin tonë u përuruan dy veprat e Prof. Vllado Popovskit “Lëvizja Kombëtare Çlirimtare Shqiptare (1890 – 1912)“, si dhe “Marrëdhëniet sovjetike–shqiptare në vitet e ’20 dhe ’30 të shek. XX”. Në këtë libër, në versionin në gjuhën shqipe vetëm kalimthi përmendet hyrja e kryengritësve shqiptarë në Shkup, ndërsa në versionin në gjuhën maqedonase, ky moment historik fare nuk përmendet.

Ky ishte vetëm një shembull konkret për të pasqyruar një realitet të studiuesve maqedonas të cilët, kur bëhet fjalë për momente të caktuara të historisë shqiptare, hezitojnë ta paraqesin realitetin karshi opinionit ose studiuesve maqedonas, ndërkohë që të njëjtën histori, e paraqesin para opinionit shqiptar.

Me këtë vetëm desha të vë në pah guximin e prof. Ramiz Abdylit që me botimin e punimeve të tij në gjuhën maqedonase ka arritur që opinionit dhe studiuesve maqedonas t'ua paraqesë historinë e shqiptarëve ashtu siç ai e sheh dhe një histori shumë pak të njohur për ta dhe të njëjtën të arrijë ta botojë në Institutin e Historisë Nacionale.

EMIN AZEMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

ESE MBI PROFILIN INTELEKTUAL E NJERËZOR TË PROF.DR. RAMIZ ABDYLIT

Me histori merremi nga pak të gjithë ne që kemi çka të rrëfejme mbi të kaluarën tonë dhe të afërme tanë, por ky nuk është thelbi i misionit të historianit. Është një tjetër dimension që e bënë historianin të jetë i veçantë në këndvështrimin e tij mbi një ngjarje që ka ndodhur, apo një proces socio-politik që ka shkaktuar ndryshime, si në perceptimin e jashtëm të fenomeneve shoqërore, ashtu edhe në thellimin e brendshëm të qasjes ndaj gjithë asaj që e bën një epokë të ndryshme nga tjetra. Për rrjedhojë, vetvetiu lind pyetja se çka duhet ta motivojë një historian, për të qenë puna e tij pikë referimi dhe orientimi për një ngjarje a proces të caktuar?

Kësaj pyetjeje janë munduar t’iu përgjigjen jo vetëm historianët, por të gjithë ata që këtë shkencë e bashkëshoqërojnë me disiplinat e përafërta, siç mund të jenë arkeologjia, antropologjia, paleologjia, letërsia, gjuhësia, etnologjia etj.

Pa një pyetje të tillë, do të ishin të zbehta edhe dilemat që qëndrojnë si shpatë demokleu mbi misterin e së vërtetës. Mbase, këtu buron edhe thënia e njohur për historianin si shërbëtor i së vërtetës. Kërkimi i së vërtetës historike, ka preokupuar njerëzit e dijeve, kurse historianët i ka bërë më përgjegjës ndaj fjalës së shkruar, duke e mbështetur vërtetësinë mbi dokumente e burime të ndryshme arkivore.

Fjalët e shkruara mbasin dokumente të pashlyera, që më vonë formojnë faktografinë. Por fjalët e shkruara mund të shprehin një emocion të caktuar edhe mbi syprinën kristalore të borës, në një fshat diku rrëzë Karadakut, sidomos kur ato vijnë natyrshëm si rrjedhojë e edukimit dhe kultivimit të ndjenjave atdhetare nëpër odat e mbushura me histori për betejat e shqiptarëve, atje ku Llojani formon një prej gurëve kujdestar të atdheut të “çliruar “nga aradhat e uzurpatorëve që uniformat e çetnikëve i kishin zëvendësuar me ato të partizanëve. Tani bora është shkri, por kujtesa për fjalën e shkruar ‘Rroftë Shqipnija’ mbi të nga një fëmijë i padjallëzuar, që më vonë do të bëhet historian i shquar, ishte ngjizur me rrëfimet legjendare për trimat dalëzotës të tokave shqiptare, si Sylë Hotla, Xheladin Kurbalia, Ajet Rainca, Sadik Llojani etj., të cilët ishin sakrifikuar deri në flijim për të bërë “Shqipninë deri te udha e frenjit”.

Por, treni i historisë nuk u ndal aty ku deshën trimat tanë dhe shqiptarët mbetën pa stacionin e shumëpritur që do t’i bënte ata të plotë në aspiratën shekullore për të qenë një e të pandarë.

Në një stacion të tillë do ta shohim edhe historianin tonë të shquar prof.dr. Ramiz Abdylin, i cili nuk do ta priste më Godonë, sepse e kishte të qartë fatalitetin e kësaj simbolike dramaturgjike, por do të priste që të rritej pak dhe t’ia mësyente bankave shkollore e universitare, fillimisht në vendlindjen e tij në Llojan, e Miratoc, pastaj në Shkup për ta përmbyllur këtë cikël formimi akademik në Prishtinë, ku edhe u punësua fillimisht në Institutin e Historisë.

Jo vetëm për shkak të formatit të vepërës së tij voluminoze, që është ngusht e lidhur me radiografinë e gjallimit shqiptar ndër shekuj, por edhe për shkak të arketipeve që dalin nga botëkuptimi i tij mbi të vërtetat e pashmangshme të kohëve që ai i jetoi e përjetoi, e bëjnë figurën e prof.dr. Ramiz Abdylit një kandil të

pashuar mbi dallgët e trazuara të detit. Ishte pikërisht emri dhe vepra e tij një mburojë që refuzonte erërat ta fiknin dritën e atij kandil, kurse opinionit shkencor e akademik i mbetet të nxjerrë mësimet e përfundime mbi efektet e ndikimit shkencor që pati prof.dr. Ramiz Abdyli në historiografinë shqiptare. Kjo edhe për faktin se në praktikën e kodifikimit të ngutshëm të vlerave shkencore ndër ne, shpesh herë ndodhë fenomeni i anashkalimit të emrave të studuesve eminent në projektet e përbashkëta të karakterit hulumtues e botues, siç është edhe prof.dr. Ramiz Abdyli. Nuk kemi arritur ta kuptojmë se çfarë kredibiliteti etik e shkencor kanë projektet e tilla, gjoja të përbashkëta, ku do të mungonte emri i prof. Ramizit, i cili, për hir të së vërtetës nuk është se po vuan nga mania e të qenit i famshëm me çdo kusht, sepse fama e tij tash më është e stampuar në një listë të gjatë veprash, por sepse ideatorët e projekteve të tilla të cunguara i ngelin borxh të sotmes dhe sidomos të nesërme me një lexim ndryshe të historisë.

Kështu, vetvetiu arrijmë të çështja thelbësore që ndërlihet me angazhimin intelektual e profesional të historianit, si në sferën publike, ashtu edhe në atë shkencore e akademike. Cili pra është statusi i historianit në shoqëri? Kjo pyetje bëhet sa herë që duam të vendosim një relacion substancial, etik e pragmatik në mes të historianit dhe politikës, historianit dhe shtetit, historianit dhe partisë politike.

Kjo pyetje, gjithashtu bëhet edhe atëherë kur duam të bëjmë dallimin në mes të historianit serioz dhe kalemngjisë që shkruan përralla pa fusnota për lavdinë e heronjve lokal të cilët i paraqet si gjithëkombëtarë.

Prof. Ramiz Abdyli, me rrugëtimin e tij të gjatë, si intelektual dhe si shkencëtar, ishte i angazhuar dhe mbetet i tillë në dy rrafshet: në rrafshin e zgjerimit të hapësirës emancipuese—arsimore të

shqiptarëve këtu në Maqedoni për disa dekada me radhë, duke kontribuar fillimisht në hapjen e paraleleve të para në gjuhën shqipe në Gjinnazin e Kumanovës, në fillim të viteve shtatëdhjeta (70-ta) dhe pastaj përkushtimi i tij në ngritjen dhe riformatimin e standardeve akademike-universitare, e shkencore, si në Universitetin e Tetovës ashtu edhe në ITShKSh, por dhe në rrafshin e zgjerimit të gamës së vrojtimit shkencor mbi periudha të caktuara historike të shqiptarëve, sidomos ato që fermentuan vetëdijen politike për shtendërtim në fund të shekullit 19 dhe në fillim të shekullit 20.

Dokumenti dhe lidhja e tij me faktet dhe dëshmitë, përbëjnë për prof. Ramiz Abdylin, kandin nga rëndon e vërteta. Dhe, jo rastësiht është thënë se e vërteta ka çmim. Sa do të mundohemi t'i vëjmë një çmim të vërtetës, sërish nuk do të mjaftojë ta valorizojmë fuqinë e argumentit, sepse është distanca kohore dhe algoritmi i faktografisë krahasuese ato që e bëjnë prodhimin shkencor të një historiani t'iu rezistojë erozioneve morale, kombëtare, njerëzore e civilizuese.

Prof. Ramiz Abdylit që nga mosha e rinisë së hershme kishte dëgjuar për luftimet që u zhvilluan mbi dy muaj e gjysmë midis forcave të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, kundër brigadave partizane serbe, maqedone dhe ushtrisë bullgare, të cilat, sikundër dihet, synonin pushtimin e trevave shqiptare në perëndim të hekurudhës Kumanovë – Bujanoc, për të depërtuar prej andej në Kosovë.

I formuar nën ritmin dhe jehonën e atyre ngjarjeve dramatike të LDB, që kanë mundur të jenë edhe arsyt vendimtare për t'u marrë pastaj profesionalisht me historinë, prof. Ramiz Abdylit në retrospektivën e kujtimeve fëmijënore do të fiksojë datën 9 shtatator 1944 kur ushtarët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, pasi kishin çliruar Preshevën, një pjesë e tyre, përmes Llojanit e Mateçit, shkuan ta çlirojnë Shkupin dhe bashkë me atdhetarë nga Kosova

dhe Pollogu çliruan pjesën vëriore të qytetit dhe e mbajtën të tillë mbi dy muaj e gjysmë.

Fëmija i dikurshëm që dëgjonte i strukur në një qoshe të odës, e mbushur me tym duhani kaçak, më vonë do ta kuptojë, madje edhe do ta trajtojë në disa punime shkencore se, luftimet që u zhvilluan në një front të gjerë ballor, që nga Kumanova deri përtej Bujanocit ishin të rrepta. Shqiptarëve iu shkuan në ndihmë vullnetarë nga ana e Gjilanit me në krye Mulla Idrizin, ndërkohë që forcat pushtuese, ndonëse kishtin epërsi në armatim dhe njerëz, nuk mundën t'iu rrezistojnë luftëtërëve shqiptarë për dy muaj e gjysmë në mbrojtjen e kësaj hapësire etnike që shkonte deri te linja hekuridhore Beograd–Shkup. Një fëmijë e mitur, që atëherë i thoshin vetëm Ramiz, e që më vonë do të njihet si historiani Ramiz Abdyli, ishte i lidhur fuqishëm me dramën e atyre ngjarjeve që prodhonin, jo vetëm katarsë e lavdi, por edhe respekt e pietet për të rënë në mbrojtje të tokave që arbitrarisht u sakatuan nga gërvanët e konferencave ndërkombëtare, në mesin e të cilëve ndodhej edhe gjyshi i tij, një bashkëluftëtar i Xheladin Kurbalisë, komandant i forcave shqiptare të Lidhjes në këtë sektor.

Ky detaj biografik në rininë e hershme të prof. Ramizit ndoshta do të mjaftojë për njerëzit e hijeve që të ngrejë aparatit e tyre të ndjekjes dheurvejimit, duke arkivuar dhe regjistruar edhe shumë aktivitete e veprimtari të tij që konsideroheshin si të rrezikshme.

Po çka mund të konsiderohet e rrezikshme nga ish sistemi, sidomos çka mund të paraqiste rrezik veprimtaria e një intelektualit dhe historiani, për një shtet i cili po mbijetonte duke u shndërruar në vesh e sy, jo për të ndjekur zhvillimin dhe përparimin, por për tëurvejuar dhe shantazhuar intelektualët e kalibrit të prof.dr. Ramiz Abdyli.

Ja, cili mund të jetë, bie fjala, “rreziku” i parë, që identifikuan tek prof. Ramizi, njerëzit e hijeve të ish sistemit.

Në mesin e viteve gjashtëdhjetë, pas mbarimit të Normales në Shkup, Ramiz Abdylin do ta gjejmë në Universitetin e Shkupit, Dega e Historisë së Përgjithshme dhe Artit. Ai ishte përcaktuar pikërisht për këtë program studimor me qëllim të shmangies nga programi tjetër –Historia e popullit maqedon me 8 semestra. U diplomova me temën për Pavarësinë e Shqipërisë në vitin 1968, tek mentorin dhe profesorin e tij, Hristo Andonov Poljanski, i cili i kishte premtuar studentit të tij të posadiplomuar se do t’i jepte ta ligjerojë lëndën Historia e Shqipërisë për studentët maqedonas. Mirëpo, kjo nuk ndodhi, pas që profesori u helmua nga sigurimi shtetëror. Prof. Ramizi s’kishte si të mos shqetësohej nga ky akt misterioz që ndërli dhej drejtpëdrejt me punën dhe kontributin e profesori Poljanski i cili pagoi me jetë qëndrimet që kishte ndaj çështjeve të caktuara të historiografisë dhe me këtë kishte dështuar edhe plani i tij që ta kishte asistent të lëndës së Historisë së popullit shqiptar pikërisht prof. Ramiz Abdylin.

Vet fakti se profesori i vrarë ishte shprehur i gatshëm të mbështesë rrugëtimin e mëtejshëm akademik e shkencor të prof. Ramiz, kishte mjaftuar të jetë një vegël në duart e njerëzve të hijes së ish sistemit, të cilëve si duket nuk iu interesonte Ramiz Abdyli si emër i shkencës, që mund të ndikonte edhe në afrimin e popujve, por Ramiz Abdyli si nxitës i proceseve emancipuese e arsimore në shoqërinë shqiptare dhe si gjoja turbullues i ujërave të qeta në detin e madh të socializmit vetëqeverisës të viteve gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë.

Hapja e paraleleve të para në gjuhën shqipe në gjimnazin e Kumanovës, në fillim të viteve shtatëdhjeta, ku kontributi i prof. Ramiz Abdylit, në këtë nismë ishte vendimtar, për dikënd mund të

paraqiste edhe rrezik, sepse mendësitë mesjetare që u trashëguan në sistemet e movonshme autoritare, tek dija dhe njerëzit e dijës shihnin njëfarë rreziku. Për ironi, këtu mbase mund ta ketë burimin edhe ajo shprehja e famshme për “shqiptarin e ndershëm” (‘posteni albanac’), që u lansua nga ish sistemi, që nënkuptonte synimin e asaj politike që shqiptarët e arsimuar t’i shihte me një njëfarë skepse dhe dyshimi, ndërkohë që me shqiptarë të ndershëm nënkuptonte shqiptarin e paarsimuar i cili për të arritur diçka në jetë duhej patjetër të bashkëpunonte me ndonjë çinovnik të UDB–ës, të komitetit, apo me ndonjë udhëheqës çfarëdo qoftë ai, sepse kjo ishte fiskultura e atëhershme ideo–politike e kërrusjes së kurrizit të dinjitetit njerëzor dhe krijimin e klimës shoqërore e politike që do të prodhonte sa më shumë shqiptarë lojalë ndaj pushtetit.

Me ardhjen e prof. Ramiz Abdylit në Kumanovë në vitin 1970 (paraprakisht kishte dhënë mësim në shkollën e Lojanit dhe Bukovikut), dhe përfshirjen e tij në procesin edukativo–arsimor si profesor i lëndës së historisë në gjimnaz dhe sidomos angazhimi i tij në hapjen e paraleleve të para në gjuhën shqipe në këtë gjimnaz dhe më vonë edhe në shkollën ekonomik dhe të teknikës. Jemi në kohën kur ky rajon verilindor i banuar me shqiptarë, po kalonte nga letargjia e viteve gjashtëdhjetë, që ishte i mbufatur me pellgje lotësh në stacione trenash e autobusësh teksa kolona e të shpërngulurve për në Turqi kishte prekur skajet më absurde të degdisjes së qenies shqiptare nëpër shkretëtirat e Anadolit, në një fazë të zgjimit kulturor, arsimor e kombëtar të shqiptarëve të kësaj ane.

Gjithsesi ky zgjim nuk erdhi vetvetiu dhe ishte pikërisht prof. Ramiz Abdylit me një grup arsimdashësish të tjerë nga rajoni i Kumanovës, përfshi edhe Arif Arifin, nënkryetin e atëhershëm të Lidhjes Socialiste të Kumanovës, që ndikoi në ndryshimin perceptimit për shqiptarët, duke e bërë të qartë se cili ishte shqiptari

i ditur e arsimuar dhe cili ishte antipodi i kësaj kategorie shqiptarësh, që aq shumë pëlqehesh nga ish-sistemi. Për rrjedhojë ‘shqiptari i ndershëm’ filloi të ndjehet keq në këtë atmosferë që e krijoi prof. Ramiz Abdyli, ndërkohë që Kumanova si rajon përfitoi shumë nga ky transformim arsimor e kulturor, për arsye se shqiptarët përpos që zgjeruan horizontin e diturive, u bënë edhe më të vetëdijshëm për statusin e tyre shoqëror e politik. Me mbështetjen e prof. Ramizit në Kumanovë u vunë edhe themelet e veprimtarisë teatrore në gjunën shqipe.

Gjithsesi, ky vetëdijësim i dha frytet disa dekada më vonë, pikërisht në vitin 2001, me kryengritjen që përfshiu ndërgjegjen kolektive të shqiptarëve për një ndryshim substancial të pozitës së tyre në Maqedoninë gligoroviane. Këto ngjarje sigurisht që nuk ishin të izoluara nga konteksti i zhvillimeve politike në hapësirën shqiptare në fund të shekullit të kaluar dhe në fillim të këtij shekulli, që rezultuan me çlirimin e Kosovës dhe me krijimin e parakushteve për një qasje më radikale në zgjidhjen e problemeve të hapura të shqiptarëve edhe në Maqedoni. Por, ato ngjarje nuk erdhën vetvetiu dhe si të tilla ato patën një prolog që ndërlidhen pa dyshim edhe me procesin e etablimit të Universitetit të Tetovës në mendësinë kolektive të shqiptarëve gjatë viteve 90-ta, i cili përpos si vatër arsimore, ishte edhe një epiqendër e formësimit të një kauze të re kombëtare që do të kulmonte me shpërthimin e kryengritjes së armatosur në vitin 2001.

Një prej pedagogëve emblematikë të këtij Universiteti, që ishte bërthama e formimit të tij, ishte edhe prof. dr. Ramiz Abdyli, angazhimi i të cilit, fillimisht si profesor, e pastaj edhe si rektor, do t’i japë këtij universiteti atributet e një agore aktive ku po piquej vetëdija sublime për ndryshime rrënjësore në shoqërinë shqiptare.

Bilanci i atyre ndryshimeve ishte kryengritja e vitit 2001, pjesë e të cilit ishin edhe studentët e prof. Ramizit.

Ky mund të jetë “reziku” tjetër që i atribuohet figurës së prof. Ramiz Abdylit, ndonëse atë asgjë nuk e demotivoi në përpjekjet për të vazhduar betejat intelektuale e shkencore, si në planin e përgatitjes dhe avancimit të kuadrove të reja, që do të ishin pasues të tij, disa prej të cilëve i kemi prezent edhe në këtë sallë, ashtu edhe në planin e veprimtarisë hulumtuese e botuese, që do t’i sillnin historiografisë shqiptare kontribute të vlefshme me të dhëna rifreskuese arxivore e dokumentare, siç mund të jenë veprat dhe studimet: Hasan Jakup Ferri – një jetë për atdhe, Trojet Lindore shqiptare në kryengritjen e përgjithshme (1912), Fjalor i historisë (ngjarje, personalitete dhe shprehje historike)”, Përzgjedhje studimesh historike 1,2,3, Malësia e Shkodrës në flakë për liri, dokumente britanike, Dokumente ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912 (bashkautor me Muhamet Shatrin), Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze 1878–1881, Vëllimi I dhe II, Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908–1910, Libri 1 dhe 2, Dokumente bullgare për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare të vitit 1912, Shqiptarët e Maqedonisë sipas të dhënave të defterëve osmanë të shek. XV–XVI dhe tash së fundmi dy veprat e më të reja të prof. Ramizit, Shkupi në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878–1881) dhe Klubi Bashkimi i Shkupit (1908–1912), të cilat do t’i promovojmë sot.

Për një intelektual aktiv dhe hulumues, siç është prof. Ramiz Abdyli, vazhdon të mbetet i hapur bilanci i angazhimeve kreative në fushën e historiografisë. Karriera e tij shkencore e filluar në vitin 1975, vazhdon të ballafaqohet me ide e projekte të reja, por pengu i vetëm i tij për momentin është dëshira e kahershme për t’u shkruar historia e mirëfilltë e shqiptarëve. Projektet ekzistuese që mbajnë firmën e disa akademikëve të Tiranës, nuk i përmbshin kriteret për

të qenë Një histori e përbashkët e shqiptarëve. Prandaj synimi i prof. Ramiz Abdylit është shumë fisnik dhe i drejtë, aq më tepër që ai disa herë është angazhuar, edhe me recensione të shkruara, në formë të vërejtjeve dhe sygjërimeve profesionale, që metodologjia e shkruarjes së historisë së shqiptarëve të ndjek edhe parimin e shtrirjes territoriale, duke mos lënë jashtë këtij projekti shqiptarët e trojeve etnike në Maqedoni, Mal të Zi, Serbi të Jugut e gjetiu dhe duke përfshi edhe studiues nga këto treva, të cilët do të kontribuonin në vjeljen e materialit historiografik e arkelogjik, si dëshmi konkrete e vazhdimësisë së pandrërës territoriale të shqiptarëve në këtë pjesë të Evropës Juglindore.

Këto pikëpanje të prof. Ramiz Abdylit burimin e kanë te ndjeshmëria e ij tepër e lartë ndaj korpusit tematik etnik, me epiqendër Shkupin, si një arterie kryesore që lidhë Dardaninë me pjesët tjera vitale të hapësirës shqiptare, që kufizohen me ujërat e Jonit e Adriatikut. Ai në Shkup e kishte kaluar rininë e hershme si nxënës i Normales dhe rininë e mëvonshme si student në Universitetin e Shkupit. Por para kësaj, ai kishte hasur në rrëfimet e odave të vendlindjes copëza historish që lidheshin me Shkupin dardan dhe që atëherë iu kishte mbjellë në mendje përkushtimi për këtë qytet të lashtë, i cili do të bëhet më i njohur për publikun e gjerë edhe në sajë të dy veprave të fundit të prof. Ramiz Abdylit që i botoi ITSHKSH – njëri mbi Shkupin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kurse tjetri mbi Klubin Bashkimi të Shkupit.

Për një shkrimtar fëmijëria dhe rinia paraqesin arkën e mbushur me përralla për të kaluarën të cilat pastaj shndërrohen në fabula tregimesh apo romanesh, ndërkohë që për një historian fëmijëria dhe rinia është paradhoma e një muzeu të vjetër ku ruhen shpatat mitologjike për t'u ballafaquar me sfidat që t'i sjell jeta. Në rininë e tij të hershme, edhe prof. Ramizi kishte magazinuar në kujtesën e

tij, në vend të shpatave mitologjike, motivet e disa këngëve të vendlindjes të cilat do t'i kujtohen herë pas herë edhe në moshën e shtyrë e që do të përputheshin plotësisht me kauzën e tij intelektuale për ta bërë Shkupin qendër të shqiptarizms.

Shkupi atë do ta ndjekë gjatë gjithë jetës, ashtu siç do t'i jehojnë në vesh edhe sot vargjet e një këngë të fëmijërisë që lidheshin pikërisht me këtë (krye)qytet të lashtë Dardan:

*Oj nana jonë,
Ner gjerman do t'shkojmë
Shkupin ta fitojmë,
Shkupi asht i joni,
T'part naj kanë lan!*

FITIM RIFATI

Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

VËSHTRIM MBI VEPRAT E BOTUARA TË PROF. DR. RAMIZ ABDYLIT, NË KUADËR TË INSTITUTIT TË HISTORISË NË PRISHTINË

Në vitin 1978, kur Profesor Ramizi, si magjistër i historisë ishte përzgjedhur punonjës shkencor në Institutin e Historisë së Kosovës, veprimtaria e tij botuese ishte e kualifikuar për t'i hyrë guximshëm rrugës së kontributit të mëtijshëm shkencor në fushën e historiografisë shqiptare. Mirëpo, që në fillesat e saj, ajo hasi në probleme të karakterit profesional dhe ideopolitik.

Që në javën e parë të punës, ai i kërkoi akad. prof. dr. Ali Hadrit, në atë kohë drejtor i Institutit të Historisë së Kosovës, t'ia caktonte për tezë disertacioni të doktoratës veprimtarinë dhe personalitetin e Hasan Prishtinës në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Mirëpo, Profesor Ali Hadri i kishte propozuar për temë “*Zhvillimi historik i PKJ–LKJ–së në Kosovë më 1945–1966*”. Kjo ishte një temë e papranueshme për profesor Ramizin, i cili, për shkak se nuk dëshironte të pranonte këtë temë disertacioni të doktoratës, rrjedhimisht kishte vendosur të largohej nga Instituti dhe të kthehej në Shkup. Me ndërhyrjen dhe ndërmjetësimin e kolegëve profesor Fehmi Rexhepi dhe profesor Jusuf Bajraktari te profesor Ali Hadri, kishin rënë dakord që tema e doktoratës për të të jetë “*Gjendja dhe pozita e klasës punëtore në Kosovë (1918–*

1941)".¹⁴ Kësisoj, krahas angazhimit në segmente të ndryshme profesionale në kuadër të këtij institucioni, përgjatë viteve 1978–1994, aq kohë sa prof. dr. Ramiz Abdyli punoi në Prishtinë, atij, më 1986, iu botua vetëm një vepër me titull "*Gjendja dhe pozita e klasës punëtore në Kosovë (1918–1941)*", Prishtinë, 1986.

Studimi ishte mbrojtur si tezë e disertacionit të doktoratës në vitin 1982. Problematika që trajtohet brenda tij si qëllim kryesor ka ndriçimin e të gjitha formave dhe karakteristikave themelore të gjendjes e të pozitës së klasës punëtore në Kosovë në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Autori nxjerr në pah Kosovën në shkallë të mjerueshme ekonomike dhe pozitë shoqërore skllavëruese nën Mbretërinë Jugosllave. Ai konstaton se klasa punëtore, pavarësisht numrit të anëtarëve të saj, kishte dalë në sipërfaqen historike të Kosovës dhe ishte lidhur me pjesën më revolucionare të forcave prodhuese të shoqërisë së kohës, për progres të mëtejme shoqëror, si në aspektin ekonomik, politik e kombëtar.¹⁵ Pra, prof. dr. Ramiz Abdyli e ka shtjelluar çështjen në radhë të parë nga këndvështrimi i eksploatimit klasor, pa lënë mënjane veçoritë tjera të zhvillimit të saj në sferën shoqërore si fenomen sociologjik dhe si faktor shoqëror i ngjarjeve që u zhvilluan gjatë asaj kohe në Kosovë. Përmes burimeve arkivore, literaturës të specializuar sipas profilit, burimeve nga terreni, janë bërë analiza e krahasime dhe janë dhënë mendime përkatëse për gjendjen ekonomike të klasës punëtore të Kosovës dhe të viseve të tjera të Mbretërisë Jugosllave. Në tërësi, kjo vepër trajton paraqitjen e marrëdhënieve kapitaliste, popullsinë, ndarjen territoriale, rrethanat ekonomike dhe strukturën e klasës punëtore, gjendjen e saj ekonomike e sociale, kushtet e

¹⁴ Intervistë e realizuar me prof. dr. Ramiz Abdyli, Prishtinë, 02.06.2021.

¹⁵ Dr. Ramiz Abdyli, *Gjendja dhe pozita e klasës punëtore në Kosovë (1918–1941)*, Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, 1986, f.5.

jetesës dhe të punës së punëtorëve, pozitën shoqërore të klasës punëtore, gjendjen e pozitën e çirakëve dhe format e lëvizjes punëtore për përmirësimin e gjendjes dhe të pozitës së saj në Kosovë.¹⁶

Në këtë studim vihet në përfundime të argumentuara shkencore, sipas të cilave marrëdhëniet ekonomike, shoqërore e kapitaliste në Kosovë depërtuan dhe u zhvilluan ngadalë, sepse ekonomia e Kosovës u karakterizua me bujqësi joproductive, me zejtarë të papërfillur, me tregti, sistem bankar e monetar të atillë, ku nuk arriti të dominonte forma e këmbimit mall–para mbi formën e këmbimit në natyrë, dhe me industri të një faze fillestare, me çka Kosova ishte vënë në pozitë të ngjashme me ato të vendeve të kolonizuara. Rrjedhimisht, kjo ka ndikuar që gjendja dhe pozita e klasës punëtore të ishte shumë e rëndë, me një përpjesëtim të madh midis pagës nominale dhe pagës reale, me orar të gjatë pune, me një papunësi të madhe, me kushte të këqija higjienike të punës dhe me mungesë pothuajse të plotë të masave mbrojtëse e të sigurisë në punë.¹⁷ Kjo vepër u përgatit pas një pune të përkushtuar kërkimore disavjeçare në arkivat e Kosovës dhe të Jugosllavisë, ishte tezë e doktoratës, që kishte hyrë si projekt i Institutit të Historisë së Kosovës (1978–1981).

Së këndejmi, pavarësisht se, në vitin 1994, prof. dr. Ramiz Abdyli kishte vazhduar punën profesionale në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup dhe në Universitetin e Tetovës, bashkëpunimi i tij me kolegët nga Prishtina vazhdoi më tej në shërbim të çështjeve shkencore, madje edhe pas çlirimit të Kosovës. Kështu, vepra e radhës me titull “*Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908–1910*”, Libri 1, dhe “*Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911–1912*”, Libri 2, u botua në vitin 2004.

¹⁶ Po aty, f.8-9.

¹⁷ Po aty.

Këtë vepër kapitale e makroprojekt shkencor në dy vëllime, prof. dr. Ramiz Abdyli e kishte përgatitur gjatë kohës sa punonte në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup. Pas botimit në gjuhën maqedonase, ajo u botua edhe në gjuhën shqipe. Ky studim u trajtua në mënyrë të gjithanshme, duke përfshirë plotësisht të gjitha trevat etnike shqiptare, në të cilat shtrihej e vepronte Lëvizja Kombëtare Shqiptare.

Në vëllimin e parë paraqiten gjerësisht çështje nga roli i shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk, Kuvendi i Ferizajt, Kongresi i Manastirit, lëvizja politike, kulturore e arsimore e shqiptarëve gjatë viteve 1908–1909, raportet dhe qëndrimin e shqiptarëve kundrejt pushtetit e reaksionit xhonturk, kuvendet e kongreset shqiptare, kryengritjen antisomane të vitit 1910, mbi qëndrimin e shteteve fqinje ballkanike dhe të Fuqive të Mëdha ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare etj. Pra, vepra trajton një lidhje konvergjente dhe divergjente të shqiptarëve me regjimin xhonturk të viteve 1908–1910. Në kontekst të pikëpanjeverve politike, Lëvizja Kombëtare Shqiptare gjatë kësaj kohe si kërkesë programatike kishte për qëllim realizimin e autonomisë së Shqipërisë, ndonëse në mbledhje të fshehta diskutohej synimi “*për krijimin e një Shqipërie në gjithë shtrirjen e saj*”.¹⁸

Vëllimi i dytë fokus trajtimin shkencor ka kryengritjet e mëdha shqiptare antiosmane të viteve 1911–1912. Në të shtjellohen problemet kryesore që e kanë shoqëruar Lëvizjen Kombëtare Shqiptare përgjatë kësaj periudhe, duke vënë në pah organizimet e armatosura për realizimin e aspiratave politike dhe kombëtare, që kulmojnë me arritjen e marrëveshjes shqiptaro–osmane në Shkup,

¹⁸ Prof. Dr. Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1, Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2004, f.432-433.

për të përfunduar me gjendjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në prag të Luftës së Parë Ballkanike.

Për hartimin e kësaj vepre dyvëllimëshe u përdorën dokumente nga arkivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë, literatura relevante historiografike dhe shtypi i kohës. Në këtë vepër, autori ka përdorur metodologjinë më të avancuar shkencore, duke bërë analiza, krahasime e interpretime të qëndrueshme shkencore. Përmes këtij studimi, prof. dr. Ramiz Abdyli sjell risi shkencore mbi ngjarje dhe personalitete, që kanë qenë të panjohura më parë nga historiografia shqiptare. Mund të themi se, studimet në dy vëllime mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1908–1912, janë kryeveprat shkencore të prof. dr. Ramiz Abdylit. Ato vazhdojnë të jenë referencat kryesore për njohjen, hulumtimin dhe studimin e historisë sonë kombëtare për vitet në fjalë.

Në tërësi, veprimtaria kërkimore–shkencore e tij shtrihet edhe në gjininë e dokumenteve të botuara, si zhanër i pazakonshëm i krijimtarisë shkencore të Institutit të Historisë para vitit 1999. Në këtë kontekst, në vitin 2004, u botua në dy vëllime dokumentesh vepra “*Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze*”. Dokumentet e paraqitura janë përzgjedhur gjatë hulumtimit të prof. dr. Ramiz Abdylit në Arkivin Qendror Shtetëror të Britanisë së Madhe (Public Record Office) në Londër, në vitin 1997, dhe janë botuar për herë të parë në gjuhën shqipe.

Në tërësi, kjo vepër dyvëllimëshe prezanton dokumente diplomatike të konsujve britanikë të akredituar në trevat shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane. Ata, përmes telegrameve, raporteve e relacioneve dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Londër, paraqesin të dhëna me interes mbi hapat e Fuqive të Mëdha, të Britanisë së Madhe, të Perandorisë Osmane, Malit të Zi dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare me organizatën e saj politike–

ushtarake Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, nga qershori i vitit 1878 deri në nëntor të vitit 1881, veçmas në kontestin kufitar të luftës shqiptaro-malazeze gjatë periudhës mars-korrik 1880.¹⁹

Në to shpalosen njoftime, analiza e interpretime të diplomatëve britanikë në raport me çështjen shqiptare, gjeografinë etnike të saj dhe luftën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e tërësisë tokësore të trevave shqiptare dhe realizimin e programit të saj politik-kombëtar. Vëllimi i parë i dokumenteve nga provenienca e burimeve angleze, përbën një informacion serioz në drejtim të njohjes së luftës shqiptaro-malazeze pas dështimit të përpjekjeve për dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë Malit të Zi.

Në vëllimin e dytë me përmbledhje dokumentesh paraqiten të dhëna mbi harkun kohor 13 qershor 1878 – 28 nëntor 1881. Në to shpalosen njoftime, analiza e interpretime të diplomatëve britanikë në raport me çështjen shqiptare dhe trevat etnike shqiptare. Paraqiten informacione me interes, për të kuptuar më gjerësisht qëndrim britanik e të Fuqive të Mëdha ndaj Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Qëndrimi i Rusisë ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të provuar me dokumente diplomatike ruse edhe tani vazhdon të jetë një boshllëk shkencor i historiografisë shqiptare. Në kuadër të ekspeditave kërkimore-shkencore, prof. dr. Ramiz Abdyli ka bërë përpjekje për të relativizuar këtë problem, duke botuar në bashkautorësi me prof. dr. Muhamet Shatrin dokumentet ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912, të cilat i kanë përzgjedhur gjatë hulumtimeve në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë. Përmes këtyre dokumenteve ndriçohen aspekte të ndryshme të Kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912 dhe të çështjes shqiptare

¹⁹ Prof. dr. Ramiz Abdyli, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze*, Libri 1, Prishtinë: Instituti i Historisë – Prishtinë, 2004, f.6.

deri në fund të atij viti.²⁰ Dokumentet nxjerrin në pah rolin e diplomacisë ruse dhe angazhimin e saj në shërbim të interesave të shteteve ballkanike kundër aspiratave jetike të kombit shqiptar. Përfaqësuesit konsullorë e diplomatikë të Rusisë të akredituar në trevat shqiptare, përmes telegrameve dhe raporteve të përditshme e njoftonin Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sankt Petersburg mbi të gjitha zhvillimet, ngjarjet dhe rrethanat kryesisht në vilajetin e Kosovës, Manastirit e të Shkodrës. Janë me interes raportet e agjentëve ushtarakë rusë, mbi bazën e të cilave bëheshin analiza dhe jepeshin sugjerime për veprime të mëtejshme diplomatike – agjenturore dhe ushtarake. Bie në sy interesimi i tyre për elementin minoritar serb në vilajetet shqiptare dhe pozitën e tij në raport me Kryengritjen e përgjithshme shqiptare të vitit 1912.²¹

Dokumentet në fjalë përbëjnë një vlerë me interes të veçantë shkencor për studiuesit e shkencave historike, për historinë e diplomacisë shqiptare, për studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare etj. Çdo hulumtim ose trajtim shkencor për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe Kryengritjen e përgjithshme antisomane të vitit 1912, pa konsultimin dhe shfrytëzimin e këtyre dokumenteve, do të ishte i mangët.

Krahas këtyre veprave, prof. dr. Ramiz Abdyli është shquar edhe me botimin e punimeve e artikujve në kuadër të botimeve të veçanta e të revistave shkencore, duke spikatur me tema të historisë së popullit shqiptar gjatë shekujve XIX–XX.

Përmes burimeve arkivore, literaturës të specializuar sipas profilit, shtypit të kohës e burimeve nga terreni, prof. dr. Ramiz

²⁰ Prof. dr. Muhamet Shatri & Prof. dr. Ramiz Abdyli, *Dokumente ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912*, Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2006, f.6.

²¹ *Po aty*, f.6-7.

Abdyli, duke përdorur metodologjinë më të avancuar shkencore, ka bërë analiza e krahasime dhe ka dhënë mendime përkatëse e interpretime të qëndrueshme shkencore. Përmes këtyre veprave të botuara prej Institutit të Historisë në Prishtinë, kuptohet se ai është ndjekur nga bindja dhe parimi shkencor se ndriçimi i historisë kombëtare shqiptare nis me burimet dokumentare të proveniencave të ndryshme, për të qenë sa më objektiv, më afër të vërtetës historike dhe për të vlerësuar drejtë ngjarjet, dukuritë dhe personalitetet.

Mund të themi se veprat dhe rezultatet e tij shkencore–historiografike, vazhdojnë të jenë referencat kryesore në kuadër të studimeve mbi historinë e shqiptarëve gjatë shekujve XIX–XX. Ato i qëndrojnë suksesshëm kritikës shkencore dhe, nga një numër i konsiderueshëm studiuesish, vlerësohen si probleme pothuajse të ndriçuara historike. Për brezat e rinj të historianëve ato janë model i një pune të përkushtuar shkencore. Si studentë, kolegë dhe miq të Profesor Ramizit, jemi me fat që vazhdojmë bashkëpunimin me të, në shërbim të përmirësimit e avancimit të metodologjisë kërkimore–shkencore dhe të ndriçimit të historisë kombëtare, e cila pret akoma gjurmim e studim.

ALBAN DOBRUNA

Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

KONTRIBUTI I PROF. DR. RAMIZ ABDYLIT NË REVISTËN “KOSOVA”

Prof. dr. Ramiz Abdyli është historiani që i ka kushtuar një jetë të tërë punës së tij studimore, ngjarjeve historike që ndodhën në trevat shqiptare me theks të veçant shokujt XIX dhe XX. Për profesorin kisha dëgjuar dhe lëxuar si student, të dhënat e mia atëher ishin si për një studiues të rëndomtë. Megjithatë, në vitin 2009 kur u punësova në Institutin e Historisë në Prishtinë, gjatë bisedave me profesorat Faruk Salihu dhe Jahja Drançolli evokonin kujtime të vullshëm për mikun dhe kolegun e tyre Ramiz Abdylin, si: përkushtimin, zellin, punën, mundin dhe dashurinë me të cilën kishte punuar dhe u kishte ndihmuar kolegëve në Institut, e kishin bërë të njohur dhe të nderuar nga studiuesit e rinj.

Përpos shumë botimeve me një fond librash, ai ka shumë shkrime, studime, analiza dhe kontribute në revisten Kosova, organ i Institutit të Historisë – Prishtinë²², në të cilën ka filluar të botojë madje para se të punësohet në këtë institucion më 1978²³.

Në artikullin e parë të botuar në këtë revistë, më 1977, “Lëvizja nacionalçlirimtare në Preshevë 1941–1945”²⁴, duke shfrytëzuar memoaret, deklaratat e organizatorëve dhe aktivstëve të

²² *Fjalori Enciklopedik i Kosovës*, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018, f.1408.

²³ *30-vjet të Institutit të Historisë në Prishtinë (1967-1997)*, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1998, f.110.

²⁴ Ramiz Abdyli, “Lëvizja nacionalçlirimtare në Preshevë 1941-1945”, *Kosova*, Prishtinë: Enti i Historisë së Kosovës, Nr.6,1977.

dalluar të LNÇ-së, materialet arkivore, ka ardhur në përfundim se Lëvizja në Preshevë ishte pjesë përbërse e LNÇ në gjithë territoret e Kosovës dhe trevave tjera shqiptare. Për këto arsye ajo ka të gjitha karakteristikat si lëvizje unike, me strategji të caktuar, me lidhje të ngushta me komitetet lokale si të: Kumanovës, Vranjës dhe të Gjilanit. Prof. Ramiz Abdyli ka nxjerrur pasojat në këtë studim që e bënte specifike LNÇ në Preshevë, pasojat e gjendjes së trashëguar në Mbretërinë e Jugosllavisë dhe nga kushtet e vështira objektive dhe subjektive në kohën e pushtimit fashist, okupimi tejet i rëndë bullgar, disponimi antijugosllav i masave shqiptare, kundërbërjet nacionale, etj. Shto edhe numrin e paktët të anëtarëve të PKJ-së, prania vetëm e kohëpaskohëshme e aradhave partizane në masivizimin e Karadakut, profesori i ka parë si pengesa të mëdha për zhvillimin më të shpejtë të LNÇ dhe të luftës së armatosur në truallin e Preshevës. Mirëpo, vitin 1943 ai e sheh masivizimin e LNÇ-së në veri dhe lindje të Preshevës, edhe pse brenda saj nuk është arritur efekti i dëshiruar, sepse nuk ishin bërë përpjekje më të mëdha për inkuadrimin e masës shqiptare në LNÇ, e cila përbënte shumicën e popullsisë në këtë trevë. Si artikull i parë i tij në këtë revistë përbën një përpjekje serioze për mënyrën e trajtimit të problemeve, shtrirjen e tyre në rrafshin lokal, qoftë për objektivitetin e qasjes e të trajtimit të tyre, apo për prirjen e autorit për t'i gjykuar e vlerësuar drejt proceset dhe ngjarjet historike në këtë pjesë të territorit shqiptar për periudhën që e ka objekt shqyrtimi.

Në përputhje me shkallën e njohjes që ka shkuar në ngjitje vit pas viti si historian, Ramiz Abdyli çonte përpara vlerat dhe arritjet më të mira të historiografisë shqiptare, duke e pasuruar njëherësh atë me risi të rëndësishme shkencore. Nisur nga qëllimi për t'i shërbyer vetëm të vërtetës shkencore, ai natyrshëm ka përcjellë edhe mesazhet me rëndësi aktuale që rrezaton periudha shumë e

rëndësishme historike që ka për objekt. Kështu ishte edhe shkrimi i radhës i botuar prej tij në këtë revistë: “Mëditjet punëtore në Kosovë në raport me shpenzimet e jetës ndërmjet dy luftërave botërore (1918–1941)”²⁵. Autori me anë të këtij studimi ka bërë përpjekje që me anë të pagës, përkatësisht shumës së parave për të cilën punëtori paguhej, pasqyrore njërin ndër elementet kryesore të gjendjes ekonomike të klasës punëtore midis dy luftërave botërore. Prof. Abdyli ka arritur të sjellë disa rezultate si: prodhimi, faktor i pandashëm i gjendjes ekonomike të çdo vendi dhe çdo periudhe kohore, ku puntorët luftonin për të përmirësuar gjendjen në të cilën ndodhenin. Duke vazhduar në këtë linjë të zhvillimit në mendimin historik Ramiz Abdyli, vazhdon zinxhir e trajtimin e problemeve që ka si objekt të tij njerëzit. Në artikullin tjetër të botuar në revistën ‘Kosova’, ai trajton ”Faktorët që ndikuan në ndryshimin e strukturës sociale në fshatin e Kosovës 1918–1941”²⁶, duke ardhur në përfundim se gjatë 23 vjetëve të jetës së saj në Mbretërinë Jugosllave, Kosova, tregoi shenja të vogla përmirësimi, të bazës së saj shumë të ulët ekonomike. Pikërisht këto rrethana dhe faktorë të tjerë autori e karakterizon fshatin e Kosovës me bujqësi primitive, me zejtarë që ishte në krizë të përhershme, me industri fillestare që ishte e ngjashme me ato të tipit kolonial, tregtia dhe sistemi bakier që nuk ia dolën të loznin rolin e tyre ekonomik, me një komunikacion dhe shërbim hotelier të nivelit të ulët që nuk i përmbushën kërkesat e popullsisë së kësaj treve. Prof. Abdyli në këtë artikull ka dhënë një lëndë dhe informacion shumë të vlefshëm

²⁵ Ramiz Abdyli, ”Mëditjet punëtore në Kosovë në raport me shpenzimet e jetës ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)”, *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, Nr.12, 1983, f.f.229-254.

²⁶ Ramiz Abdyli, ”Faktorët që ndikuan në ndryshimin e strukturës sociale në fshatin e Kosovës 1918-1941”, *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, Nr.15, 1986, f.f.159-175.

për lexuesin shqiptar, me anë të cilit provon se përparim shoqëror aq i dëshirueshëm për shqiptarët e Kosovës në këtë periudhë, ishte aq i vështirë, i gjatë, i komplikuar që kërkonte qendres dhe vendosmëri, për t'i bërë ballë mekanizmave të një shteti autoritar, që me anë të presionit ekonomik po ju bënte jetesën të pamundur në Kosovën e midis dy luftërave botërore.

Çështje të tjera me interes që ka sjellë prof. Abdyli në këtë revistë, është "Zef Lush Marku militant i Lëvizjes në Kosovë dhe në Maqedoni (1885–1920)"²⁷, në të cilin përshkruan jetën dhe veprimtarinë e tij që përkundër kushteve të rënda veprimi, kur ai veproi, ia doli me suksese të udhëheq forcat progresive, për t'i sendërtuar idealet e tij për barazi midis kombeve dhe kombësive. Profesori ka bërë përpjekje profilizimin e një komunisti ta trajtoj në kontekstin shoqëror dhe politik të kohës, sepse komunizmi qoftë si teori, qoftë si praktikë ka një histori të gjatë perceptimi pozitiv, i cili ushqeu ëndrrat me sublime njerëzore: shoqëri e të barabartëve, shoqëri ideale, i cili vinte nga perceptim pozitiv të personalitete të shquara të mendimit botëror filozofik, kulturor, artistik etj., që nga gjysma e shek. XIX e deri në vitet gjashtëdhjeta–shtatëdhjeta të shek. XX²⁸.

Prof. dr. Ramiz Abdyli ka dhënë një kontribut me vlerë në studimet për kryengritjen e vitit 1912, ai në artikullin "Shtypi bullgar mbi kryengritjen e përgjithshme shqiptare të vitit 1912"²⁹,

²⁷ Ramiz Abdyli, "Zef Lush Marku militant i Lëvizjes në Kosovë dhe në Maqedoni (1885–1920)", *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, Nr. 17, 1988, f.f. 267–299.

²⁸ Emine Arifi-Bakalli, *Profili i Hajdar Dushit në kontekstin e dhënë historike*, Hajdar (Beg) Dushi jeta dhe veprimtaria patriotike e heroit të popullit, Prishtinë: Shoqata e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të Kosovës dhe Shoqata e Intelektualëve "Jakova", Gjakovë, 2012, f.f. 69–70.

²⁹ Ramiz Abdyli, "Shtypi bullgar mbi kryengritjen e përgjithshme shqiptare të vitit 1912", *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, Nr. 18/19, 1996, 59–73..

sjellë vemendjen e veçantë të Kryengritjes së Përgjithshme Antios–mane të vitit 1912, për aq sa lejoi strategjia e politikës afatgjate bullgare ndaj trojeve shqiptare. Sipas prof. Abdylit kishte qëndrim të drejtë derisa nuk u rrezikuan objektivi i parë i saj. Pas çlirimit të viseve shqiptare të premtuara me projektin e Shën Stefanit, filloi etapa tjetër e shkrimit të shtypit bullgar, që ndryshonte nga e para. Tashmë kryengritja shqiptare dhe shqiptarët paraqiteshin pa kurrfar ideali, të pakulturuara, që nuk e meritojnë lirinë, madje si dhunues e terrorizues të minoritetit të krishterë, vetëm e vetëm pse kishin çliruar trojet etnike të banuar ndër shekuj me shumicë. Po ashtu duke shfrytëzua burimet bullgare profesori botoi një artikull në nr.20/21 "Pavarësia e Shqipërisë sipas burimeve bullgare"³⁰, në të cilin shfrytëzoi një mori materialesh, që ishin produktit i politikës së jashtme shumë aktive bullgare, e cila duke synuar krijimin e një bullgarie sa më të madhe, që prekte thellë dhe intergjitetin territorial shqiptare, madje ushqente aspirata për të dalë në bregdetin Adriatik.

Është me interes materialet dhe të dhenat që sjellë profesori në artikullin "Lëvizja Kombëtare Shqiptare përballë grushtetit të prillit 1909"³¹, duke pasqyruar vigjilencën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare më 13 prill 1909, në mbrojtjen konstitucioinale duke mos mbështetur grushtshtetin, por as regjimin e Turqve të Rinj. Ata mbështetën Kushtetutën, nga e cila shpresonin të jetësonin të drejtat e tyre elementare kombëtare, siç ishte shkollimi në gjuhën amtare me alfabet kombëtare. Ndërkaq, konflikti midis politikës së centralizmit dhe otomanizmit të Turqve të Rinj, në një anë, dhe aspiratave autonomiste të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në anën tjetër, sa po

³⁰ Ramiz Abdyl, "Pavarësia e Shqipërisë sipas burimeve bullgare", *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, Nr.20/21, 1998/1999, f.104, f.83-104.

³¹ Ramiz Abdyl, "Lëvizja Kombëtare Shqiptare përballë grushtetit të prillit 1909", *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, Nr.22/23, 2003, f.f.125-147.

kalonte koha po përshkallëzohej gjithnjë e më shumë. Konflikti shqiptar–xhonturk ishte i paevitushëm. Duke qenë njohëse i mirë i kësaj periudhe dhe kërkues shumë vjeçare prof.Abdyli botoi në numrin që do të vinte artikullin “Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912 dhe lëvizja e oficerëve”³², në të cilin sjellë fakte interesante se si lëvizja e oficerëve, i cili në fakt përbënte krahun më militant të opozitës dhe gjeneratorin e luftës kundër turqëve të rinj, të cilët nuk i mbajtën premtimet, shkaktuan pakënaqësi e pjesës më të madhe të shoqërisë osmane, si dhe të popujve të nënshtruar të Perandorisë, andaj objekt trajtimit i këtij studimi është: kryengritja shqiptare faktor vendimtar i daljes së saj në skenën politike osmane publikisht, apo ishte kjo një ko incidencë?

Artikulli shkencor më dinjitoz i botuar në revistën Kosova, nga prof. Ramiz Abdyl, është “Qëntimet mbi shqiptarësinë e Shkupit gjatë pushtimit osman”³³, i botuar në vazhdimë në dy numra 28,29/30, është një arritje e rëndësishme e autorit në veprimtarinë e tij kërkimore–shkencore, burim referimi për studiuesit e mëvonshëm. Artikulli përfshinë një periudhë të gjatë kohore që nga periudhat më të hershme të historisë sonë e deri në 28 nëntor 1912 ku Kuvendi i Vlorës shpalli pavarësinë e Shqipërisë, Shkupi dhe shumë vise të tjera shqiptare mbetën jashtë kufijve politikë të Shtetit Shqiptar. Autori na jep një analizë të mirargumentuar, duke u bazuar në shumë burime për strukturën etnike të gjithë kësaj krahine e cila historikisht i ishte shqiptare, i cili deri në termentin e vitit 1963 mbeti qyteti më i madh në Ballkan i banuar nga shqiptarët. Kjo shënon nivelin më të lartë në studimet shkencore të

³² Ramiz Abdyl, “Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912 dhe lëvizja e oficerëve”, *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, Nr.24-25, 2003, f.f.85-116.

³³ Ramiz Abdyl, “Qëntimet mbi shqiptarësinë e Shkupit gjatë pushtimit osman”, *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, Nr.28, 29/30, 2006, 2008.

profesorit, prandaj meriton përgëzimet dhe urimet më të mira për këtë punë të vyer që e nderon atë si shqiptare dhe studiues.

Gjatë viteve të okupimit serb (1989–1999), prof. dr. Ramiz Abdyli morri mbi vete barrën e rëndë e kryeredaktorit të revistes të re, të quajtur po ashtu “Kosova”, në një kohë ku askush nuk kishte guxim të merrte mbi vete një përgjegjësi kaq të madhe për historigrfinë shqiptare. Kjo revistë ishte një botim i përbashkët i Institutit të Historisë të Prishtinës dhe i Institutit të Historisë të Tiranës. Ajo doli nga viti 1993 deri në vitin 1999 gjithsej 8 numra në gjuhën shqipe dhe angleze. Revista u shpërndahej përfaqësuesve diplomatik përmes Zyres së Republikës së Kosovës në Tiranë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Kishte për qëllim sensibilizimin dhe informimin e opinionit politik dhe diplomatik për gjendjen e Kosovës, të kaluarën e saj dhe luftën që bënte për çlirimin nga pushteti serb. Nëpërmjet artikujve shkencor revista u përpoq t’u kundërvilej shtrembërimeve që i bëheshin prej shumë kohësh historisë së Kosovës nga historigrafia serbe³⁴.

Mbështetur në atë që u tha më lartë, prof. dr. Ramiz Abdyli, ka kryer një punë voluminoze, ka punuar me përkushtim të madh për grumbullimin e të dhënave, ka trajtuar me rigorozitet e me objektivitet proceset, ngjarjet dhe fenomenet historike në revistën “Kosova”, duke patur një qasje origjinale në trajtimin e problemeve, sidomos përfundimet në të cilat ka arritur, konsideroj se përbënë një kontribut në studimet e historisë së popullit shqiptar.

³⁴ *Fjalori Enciklopedik i Kosovës...*, f.1409.

BESNIK RAMETI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

**PROF. DR. RAMIZ ABDYLI, SI LIGJËRUES
DHE REKTOR NË UNIVERSITETIN
E TETOVËS**

*Kush është prof.dr Ramiz Abdyli
(Biografi e shkurt)*

Prof. dr. Ramiz Abdyli, është studiuesi më i madh i historigrasfisë shqiptare në Maqedoni i periudhave të shekullit XIX dhe XX. Ai ka punuar me përkushtimin më të madh në fushën e historisë, por ajo më e rëndësishme ka qenë grumbullimin e dokumentave dhe fakteve historike të cilat janë publikuar dhe botuar në veprat e tij dhe në revistat shkencore. Serioziteti dhe puna profesionale shkencore i ka dhënë jehonë si në vend por edhe në rajon, ku është ngritur në një pedestal të lartë shkencor dhe përkrahës në çdo drejtim të jetës në periudha të ndryshme që i ka shërbyer institucioneve më të larta e të mirëfillta shkencore si në Shkup, Prishtinë, Tiranë dhe në Evropë dhe në botë.

Prof. dr. Ramiz Abdyli ka lindur më 1944 në fshatin Llojan të Kumanovës. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, të mesmen dhe Fakultetin e Historisë e ka kryer në Shkup, ku ka diplomuar në vitin 1976, ndërsa disertacionin më 1982 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

Ai si mësimdhënës ka punuar së pari në vendlindje, në f. Llojan të Kumanovës dhe në f. Bukoviq të Shkupit. Më vonë punësohet

profesor në Gjinnazin e Kumanovës. Gjithashtu vlen të theksohet edhe kontributi i tij si gazetar në “*Flakën e Vëllazërimit*” në Shkup. Profesor Ramiz Abdili ka qenë i punësuar në Institutin e Historisë në Prishtinë për një periudhë të gjatë dhe në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup deri në dhjetor të vitit 2002. Në dhjetor të vitit 2002 e deri në mars 2003, ishte rektor i Universitetit të Tetovës, ndërsa në vitin 2008, zgjedhet drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Këtë detyrë e ka kryer deri në vitin 2010. Tani është në pension dhe vazhdon pa u ndalur në punën shkencore të historisë.

Angazhimi profesional Prof.dr. Ramiz Abdylit në institucionet shkencore

Angazhimi profesional i Prof.dr.Ramiz Abdylit në studimet shkencore e ka angazhuar të jetë anëtar i redaksive në disa revista shkencore, si dhe anëtar i Bordit të botimeve të Institutit Biografik Amerikan të Karolinës Veriore, kryeredaktor i revistës „Kosova“ në shqip dhe anglisht, të cilat i kanë nxjerrë dhe botuar Instituti i Historisë në Prishtinë si dhe Instituti i Historisë në Tiranë në vitet 1993–2000.

Puna dhe veprimtaria shkencore e prof.dr Ramiz Abdylit ka dëshmuar qartë ku ka publikuar me dhjetëra e dhjetëra punime shkencore, trajtesa, recensione, vështrime dhe shkrime të tjera publicistike, që janë botuar në revista shkencore e publicistike të kohës në Shkup, në Kosovë, në Shqipëri e në Kroaci. Ai ka udhëhequr disa projekte hulumtuese–kërkimore nga fusha e historisë, ka marrë pjesë në shumë seksione, konferenca e kongrese shkencore me kumtesa për problem të caktuara të Historisë së Popullit Shqiptar (Koha e Re) të organizuara në Prishtinë, në

Tiranë, në Maqedoni, në Londër, në Stamboll, në Sofje, Beograd e në Zagreb.

Është me rëndësi të theksohet se në shenjë mirënjohje për sensibilizimin e çështjes së Kosovës dhe të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, Instituti Biografik Amerikan i Karolinës Veriore, prof. dr. Ramiz Abdylin e ka zgjedhur si personalitet në mesin e 5000 personaliteteve më të shquara të botës për vitin 1998.

Kontributi i Prof.dr. Ramiz Abdyli, si ligjërues në Universitetin e Tetovës

Me shpërbërjen e Federatës Socialiste Jugosllave dhe me fillimin e pluralizmit politik në Maqedoni në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, për shqiptarët e këtushëm ishte e nevojshme të hapet një universitet në gjuhën shqipe, sepse studentët shqiptarë që studionin në universtetet e vendit diskriminoheshin dhe nënçmoreshin andaj nuk kishte rrugë tjetër dhe i detyruan të hapin universitet. Ideatori dhe protagonist kryesor ka qenë prof. dr. Fadil Sulejmani dhe elita e shkolluar bashkë me popullin.

Më 17 dhjetor të vitit 1994 u hap Universiteti i Tetovës. Nga nevoja për profesorë të përgatitur për t'i shërbyer këtij tempullit të dijes, prof. dr. Ramiz Abdyli pa hezitur angazhohet si ligjërues në Fakultetin Filozofik – Katedra e Historisë, që nga viti i parë akademik 1994/95 deri në vitin 2008/2009. Ai me autoritetin e tij do t'i motivonte edhe shumë profesorë të tjerë të historisë nga Kosova e Shqipëria për të ligjëruar në këtë universitet, si: prof. dr. Jahja Drançollin, prof. dr. Exhlale Dobrunën, prof. dr. Hysni Myzirin, etj.

Prof. dr. Ramiz Abdyli në UT ka ligjëruar lëndën “Historia e Popullit Shqiptar II” me një profesionalizmin të lartë dhe me plot

krenari e nderë, duke dëshmuar rangun e lartë të një historiani çdoherë të saktë dhe të singertë. Ai ka qenë përkrahës dhe motivues i madh i studentëve të historisë. Përpos vështirësive që sillte regjimi shtetëror, ai me shumë kolegë të tij, nxorën shumë profesorë, magjistra dhe doktorë të shkencës së historisë. Prof.dr. Ramiz Abdylit iu dha edhe detyra e prodekanit në Fakultetin Filozofik, punë të cilën e menaxhonte mjaft mirë dhe në harmoni me kolegët në funksionimin e fakultetit. Lëndën “Historia e Popullit Shqiptar II” e ligjëroi deri në dhjetor të vitit 2002, ku kam pasur edhe une fatin ta kem profesor gjatë vitit akademik 2002/03 dhe kryetar komisioni në mbrojtjen e temës së diplomimit.

Me zyrtarizimin e Univesitetit të Tetovës, prof. dr. Ramiz Abdylit u zgjodh profesor i rregullt në Katedrën e Historisë, ku ligjëronte lëndët “Historia e Popullit Shqiptar III”, “Historinë e Rilindjes Kombëtare deri në Pavarësinë e Shqipërisë”, si dhe lëndën “Historia e Kohës së Re”.

Prof. dr. Ramiz Abdylit, rektor i Universitetit të Tetovës


Prof.dr. Ramiz Abdylit u zgjodh rektor i Universitetit të Tetovës, me vendim të Senatit me datë 18.12.2002, dhe në këtë detyrë qëndroi deri më 08.03.2003. Edhe pse qëndroi relativisht shkurt në këtë detyrë, ai synimin kryesor e ka pasur legalizimin e Universitetit të Tetovës nga ana e shtetit dhe të njihet zyrtarisht si institucion i lartë arsimor-shkencor në gjuhën shqipe,

Edhe përkaj pengesave të shumta nga organet e caktuara shteti, ai e planifikoi me kohë fillimin e procesit të bisedimeve për zyrtarizimin e plotë të UT-së, me miqtë e vet dhe institucionet shtetërore. Por nga problemet e brendshme të krijuara në këtë proces, prof. dr. Ramiz Abdylit dha dorëheqje nga posti i rektorit më

08.03.2003, dhe në jetën profesionale u angazhua sërish në fushën e historisë.

Faleminderit për përkrahjen tuaj i nderuar prof. dr. Ramiz Abdyli, dhe për kontributin e dhënë në shkencën e historiografisë shqiptare!

PROMOVIMI I DY VEPRAVE TË
PROF.DR. RAMIZ ABDYLIT



SKENDER ASANI

Drejtor i ITShKSh-së dhe recensent

KËTO VEPRA DO TË JENË SHTYLLA KRYESORE E SHKRIMIT TË HISTORISË SË SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË

Jam i nderuar të them disa fjalë për këto dy vepra kapitale, për historiografinë shqiptare edhe në cilësinë e recensentit.

Në të vërtetë, shqiptarët shumë vonë kanë filluar ta shkruajnë historinë e vetë. Në vitet e 20-ta të shekullit të kaluar, mbreti Ahmet Zogu i thërret studiuesit botëror të asaj kohe në Shqipëri që të shkruhet historia e shqiptarëve. Për fat të keq, për shkak të marrëdhënieve me Serbinë, ajo histori anashkalon gati 80 përqind të historisë së popullit shqiptar, domethënë të trevave verilindore shqiptare, të cilët nuk përfshiheshin në atë histori. Periudha më e mirë për shqiptarët, e cila fatkeqësisht deri më tani ende nuk është tejkaluar, ka qenë periudha e Luftës Dytë Botërore, kur ministër i Arsimit ishte Ernest Koliqi, i cili i solli këtu mësuesit nga Shqipëria për të mbjellë farën kombëtare edhe në teritorrin e sotëm të Maqedonisë, (për fat të keq pa Shkupin dhe Kumanovën), por ka reflektuar pozitivisht për mbjelljen e farës kombëtare që i ka bërë rezistencë gati çdo periudhe historike deri në ditët tona. Në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, historiografia ndërton vetëm një histori që e përfshinë vetëm Shqipërinë Londineze, e cila anashkalon përsëri atë 80 përqindëshin e historisë së shqiptarëve, dhe nuk përfshihej territori verilindor i trevave shqiptare. Për fat të keq, edhe paralajmërimet e tashme për shkruarjen e historisë së shqiptarëve, unë jam i bindur se nuk do të përfshihet përsëri një 80

përqindësh i historisë së shqiptarëve. Për mos me ra ndesh me historiografinë ose me politikën ditore të Shkupit dhe Beogradit ajo ka anashkaluar historinë e shqiptarëve. Andaj, këto dy vepra të cilat ne po i promovojmë sot të profesorit të nderuar Ramiz Abdyli, do të jetë bartëse të shumë proceseve deri te shkrimi i historisë së shqiptarëve të Maqedonisë, që pastaj kjo histori e shqiptarëve të Maqedonisë të bartet në Historinë e Popullit Shqiptar. Kështu do të duhet të shkojë realisht rrugëtimi i shkrimit dhe rishkrimit të Historisë së Popullit Shqiptar.

Me rastin e botimit të këtyre dy librave, unë deshta t'i them vetëm një dy-tre gjëra dhe ngjarje që më kanë ndodhur mua, por që kanë qenë të lidhura me profesorin, e të cilat gjëra s'i kam thënë askund tjetër. Ishte viti 1998, kur gjenerata e parë përfundonte studimet, dhe në fund të ligjëratave ndodhi burgosja e shumë studentëve të gjeneratës së parë të cilët ishin bartës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për fat të keq, shumë profesorë që ishin në atë katedër, iknin nga studentët e gjeneratës së parë që mos përfundojnë studimet. Pra, ne ishim të sulmuar jo vetëm se nga shteti, por edhe nga shumë profesorë të cilët frikoheshin të marrin obligim që studentët t'i përfundonin studimet. Ishte prof. dr Ramiz Abdyli, nga të vetmit profesorë, ai i cili u doli në ndihmë studentëve dhe unë i kam shprehur falënderimet edhe publikisht nëpër media të ndryshme.

Prof. dr Ramiz Abdyli është më meritori dhe orientuesi i im në shkencë, dhe unë e kisha fatin ta mbrojtë temën në Universitetin e Tetovës, dhe më pas të jem edhe asistent i profesorit.

Tani dua të rrëfej edhe një ngjarje e cila lidhet pikërisht me këto libra! Ishim në hulumtime në Tiranë ku hulumtuam periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit edhe periudhën e fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Për mua ishte një çudi dhe një

emocion i jashtëzakonshëm t'i preki letër-këmbimet e rilindasve tanë. Pas hulumtimit ishim të përcjellur vazhdimisht nga shërbimet maqedonase në Tiranë. Meqë përcilleshim çdo hap, në mënyrë që ato hulumtime të mos na shkonin huq, u ndamë në dy drejtime, profesori erdhi nga Qafëthana, ndërsa unë nga rruga e Kosovës dhe ilegalisht i futëm dokumentet në Kosovë, në Malsinë e Gjakovës, ku na priti Harun Aliu – sot dëshmor i kombit. Pra, me një orgnizim të mirfilltë i bartëm të gjitha dokumentet historike edhe në Shkup, dhe ja në këto libra janë edhe ato ngjarje që nxjerrin në sipërfaqe historinë e popullit shqiptar.

Një ngjarje tjetër që do ta rrëfejë ka të bëjë me familjen Kumbara, e që lidhet pikërisht me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Jashar Beun dhe Emin Beun. Njëri ishte kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe tjetri delegat në Kongresin e Manastirit dhe financues. Dihet fortë mirë se gjithë familjet bujare shqiptare që kanë kontribuar për çështjen kombëtare, pas 1945–tës, me një program të qartë, sistemi komunist iu ka vërsulë që t'i asimilojë ato familje që kanë qenë mburoja e kombit, dhe me njëfarë foem ia kanë arritë qëllimit që pasardhësit e tyre mos të ndjehen shqiptarë! Por, falë profesor Ramiz Abdylit, e vërteta po del në shesh. Ai ka hulumtuar dhe e ka identifikuar kontributin e Jashar bej Shkupit por edhe të Emin beut që lidhet edhe me veprën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por edhe me Klubin “Bashkimi” të vitit 1908 – 1912, dhe këto dy personalitete lidhen edhe me këto dy libra.

Unë jam i bindur se këto dy libra do të jenë vepra monumentale të cilët do të sjellin prurje të reja në historiografinë tone shqiptare dhe do të jenë një informacion për ata që kanë nisur ta shkruajnë historinë e shqiptarëve. Kur do t'i shohin këto libra, do të mendohen se më nuk shkon ajo periudhë e shumëgjatë që e ka prodhuar historinë e Shqipërisë dhe shqiptarëve pa e përfshirë 50

përqind e territoreve shqiptare. Këto dy vepra do të jenë shtylla kryesore e shkruarjes e historisë së shqiptarëve të Maqedonisë, sepse pa Shkupin dhe Manastirin nuk shkruhet historia e shqiptarëve.

SEVDAIL DEMIRI

Recensent

SHQIPTARËSIA E SHKUPIT SHKENCËRISHT PO BETONOHET ME DY VEPRA MADHORE TË PROF. ABDYLIT

Sot për Shkupin në përgjithësi, dhe për Institutin tonë në veçanti, është një ditë e shënuar, meqë shqiptarësia e Shkupit shkencërisht po betonohet me dy vepra madhore të profesorit dhe studiuesit të spikatur të historiografisë shqiptare, Ramiz Abdylit!

Pa dashur aspak ta minimizoj punën e shumë autorëve tjerë kompetentë që në Institutin tonë kanë botuar apo promovuar vepra të shumta të natyrës historiografike, nuk do ta teprojmë aspak nëse themi se me këto dy vepra të prof. Abdylit, Shkupit shqiptar i kemi vu kurorën e historisë sa i përket zhvillimeve gjatë dy ngjarjeve më të mëdha historike që kanë ndodhur gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare – Lidhja e Prizrenit dhe Kongresi i Manastirit. Zaten, i ndodhur në mes të këtyre dy qendrave të mëdha shqiptare të kohës, pra Manastirit dhe Prizrenit, qyteti i Shkupit s’ka se si të mos ishte strofull e ideve dhe veprimeve të mendjeve më të ndritura të kombit, si Hasan Prishtina, Jashar bej Shkupi, Isa Boletini, Idriz Seferi, e të tjerë. Ndërsa, autori Ramiz Abdylit, s’ka se si të mos i nxirrte këto dy vepra kaq të kompletuara dhe të argumentuara shkencërisht, pas shumë viteve e dekadave të kaluara nëpër hulumtime e studime të thella rreth këtyre temave nëpër arkivat e shumta shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Ai deri më tani ka botuar disa libra dhe punime shkencore që ndërliken me këto dy tema qendrore për të cilat po flasim sot, e të cilat vijnë

si një rrumbullakim dhe kurorëzim i suksesshëm i gjithë punës së tij të palodhshme hulumtuese – shkencore.

Vepra “Shkupi në Lidhjen e Prizrenit 1878–1881”, jep një pasqyrë të qartë të të gjitha zhvillimeve historike të kohës, brenda të cilave u zhvillua Lidhja e Prizrenit, dhe në veçanti lidhur me rolin e Shkupit dhe prijësve të saj në këtë kuvend kombëtar. Siç do të shënojë prof. Abdyli, ‘që nga themelimi i Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Shkup, krahu i saj autonomist, me në krye Jashar bej Shkupin, me pasuesit e tij zhvilloi veprimtarinë intensive për jetësimin e vendimeve të Kuvendit themelues të Lidhjes së Prizrenit në mbrojtje të Atdheut, çlirimin e tokave të pushtuara dhe formimin e Vilajetit autonom shqiptar’. Fatkeqësisht, qëllimet e Lidhjes nuk arritën të realizohen, dhe Porta e Lartë kishte filluar një ofensivë për shuarjen e saj. Të parët që sulmohen në tradhti dhe syrgjynosen, ishin krerët e Degës së Shkupit, të kryesuar nga Jashar beu. Ndërsa, veprimet e tyre mbesin ideale të pashuara në ndërgjegjen tonë kombëtare.

Libri “Shkupi në Lidhjen e Prizrenit 1878–1881” i autorit Ramiz Abdyli, ka rreth 160 faqe, dhe mbështetet në burime arkivore dhe literaturë të pasur shkencore historike, duke përdorur me saktësi mbi 500 fusnota, të cilat këtë vepër e ngritin në nivelet më të larta të literaturës bashkëkohore historiografike.

Ndërsa, vepra tjetër me titull “Veprimtaria e Klubit të Shkupit 1908–1912”, është një lloj vazhdimësie e trajtimit të temave neuralgjike kombëtare të autorit Ramiz Abdyli, që përsëri për kryefjalë e ka Shkupin. Ai thotë se motivi që e nxiti t’ia kushtonte këtë libër veprimtarisë politike dhe atdhetare Klubit “Bashkini” të Shkupit, është shqiptarësia e këtij qyteti ndër shekuj, që nga Mbretëria e Dardanisë, qendra e Provincës Dardane, dhe kryeqendër e Vilajetit të Kosovës. Shkupi edhe në këtë kohë ishte

zenra dhe qendra politike dhe kombëtare e Kosovës. Prandaj me të drejtë një etnograf shqiptar e ka thënë se Shkupi ishte ‘Qendra e Shqipërisë Verilindore’.

Përmes kësaj vepre, lexuesi krijon një tablo të qartë rreth veprimtarisë së përgjithshme arsimore, kulturore dhe politike të Klubit “Bashkimi” të Manastirit, që pas Kongresit të Alfabetit u zgjerua në qindra degë në mbarë hapësirën kombëtare shqiptare të kohës, duke u bërë një fanar ndriçues i papërsëritshëm. Nga të gjithë këto, Klubi i Shkupit po zhvillonte një punë kolosale me të gjitha kapacitetet e tij të mundshme. Por, ai me të drejtë po i jepte përparësi ngritjes së ndërgjegjes kombëtare, që do të arrihej përmes arsimimit të shqiptarëve në Shkup, dhe përgjithësisht në vilajetin e Kosovës. Veç kësaj, Klubi i Shkupit ndihmoi jashtëzakonisht shumë në ngritjen e klubeve të tilla në Kumanovë, Mitrovicë, Tetovë dhe Preshevë. Shkolla shqipe e Shkupit, bashkë me Orkestrën muzikore “Zana e Malit” dhe gazetën “Shkupi”, përbënin shtyllat kryesore të përpjekjeve për emancipim kombëtar, që zënë vend të merituar në këtë vepër, e cila shtrihet në 214 faqe, dhe për to autori ka shfrytëzuar mbi 850 fusnota.

Për fund, bashkë me urimin e përzemërt të prof. Ramiz Abdylit për këto dy vepra monumentale për Shkupin, më lejoni që të shprehë edhe një dëshirë në formë të kërkesës ndaj profesorit! Meqë origjina e tij është pikërisht treva e Kumanovës, dhe duke e ditur se ai gjatë kohë ka hulumtuar edhe për historikun e kësaj treve të begatshme me ngjarje dhe histori, uroj që prof. Ramiz Abdylit të ketë shëndet dhe elan pune, për t’ia lënë edhe Kumanovës një vepër të këtillë të mirëfilltë shkencore!

Ju faleminderit shumë!

*EMIN AZEMI**Redaktor*

MONOGRAFIA “VEPRIMTARIA E KLUBIT TË SHKUPIT (1908–1912)” NJË GRAVURË E STILIZUAR MBI MERMERIN E KUJTESËS SONË KOMBËTARE

Nuk mund të shkruash për një ngjarje, apo për një vendbanim, pa pasur fillimisht një farë ndjesie të caktuar, jo vetëm intelektuale, por edhe emocionale e njerëzore për të. Kjo ndjesi e ka udhëhequr edhe prof.dr. Ramiz Abdylin, i cili kredon e tij botëkuptimore e shkencore e ka ngushtë të lidhur me Shkupin, këtë qytet të lashtë, nëpër të cilin kalonte nervatura kryesore e trungut etnik shqiptar. Ai jo rastësisht e ka përqendruar vëmendjen prej studiuesi pikërisht në këtë qytet, për arsye se Shkupi në dioptrinë e tij paraqet piemontin e një lavdie që kishte ndodhur por që kishte mbetur e patrajtuar, prandaj edhe ka zgjedhur të veçojë një prej periudhave më të pasura me ngjarje dramatike (1908 – 1912), që ishin të lidhura ngushtë me aspiratat e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe ideologut kryesor të saj, Abdyl Frashërit, sipas të cilit, Shkupi herë do kurdo duhet të jetë kryeqendra e Shqipërisë etnike.

Lidhjen e tij me Shkupin, Prof.dr. Ramiz Abdyli, tash së fundmi ka dashur ta shpërfaqë përmes një vepre që risjell në vëmendjen tonë lavdinë e dikurshme të këtij qyteti të lashtë.

Monografia “VEPRIMTARIA E KLUBIT TË SHKUPIT (1908–1912)” vjen në opusin shkencor të prof. Ramizit si gravurë e stilizuar mbi mermerin e kujtesës sonë kombëtare, e cila tash e tutje bëhet edhe më kuptimplote për arsye se historiografinë

shqiptare e pasuron me një këndvështrim të munguar deri më tani, por edhe për faktin se, siç e thotë edhe autori: “motivi që më nxiti t’ia kushtoja këtë libër veprimtarisë politike dhe atdhetare klubit “Bashkimi” të Shkupit, është shqiptarësia e këtij qyteti ndër shekuj...”

Duke na e bërë të njohur veprimtarinë e Klubit “Bashkimi” të Shkupit, me kryetar Hamdi beun dhe nënkryetar Bajram Currin, autori hedhë dritë mbi një fazë të ndritshme të Lëvizjes sonë kombëtare, e cila e kishte kontinuitetin e saj të pashkëputur që nga koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e deri te shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (1912).

Veprimtaria e këtij klubi kap dimensionin më aktiv të zhvillimeve politike e kombëtare në mbarë hapësirën shqiptare, atëherë kur po finalizohet përpjekja për një mëvetësi politike e shtetërore shqiptare, ku Shkupi jo rastësisht ishte zgjedhur epiqendra e atyre zhvillimeve.

Këtu qëndron edhe rëndësia e të shkruarit të këtij kapitulli të munguar të Historisë së shqiptarëve, për arsye se deri më tani askush nuk është marrur me klubet shqiptare, dhe sidomos me Klubin “Bashkimi” të Shkupit, që ishte shprehja e drejtpërdrejt e aspiratës së Rilindasve tanë që në çdo qytet shqiptar të bëjë dritë një kandil diturie e emancipimi.

Klubi i Shkupit, i ideuar si motor që do të vinte në lëvizje ndërgjegjen kombëtare, me mjete politike dhe luftarake, ishte klubi i parë politik shqiptar që u themelua në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës, vetëm disa ditë pas klubit të Manastirit, në fund të gushtit 1908.

Arsyet ishin të shumta, por nga ajo që shkoqitet në mono-grafinë e prof.dr. Ramiz Abdylit, kuptojmë se Klubi i Shkupit, si organizatë politike—atdhetare e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, u

themelua për të dy arsye kryesore: të mobilizojë së brendshmi masat që do të ishin në funksion të rezistencës dhe të afirmojë çështjen shqiptare në rrafshin ndërkombëtar diplomatik e mediatik.

Duke qenë bërthama e një qeverie të ardhshme, që prodhonte ngjarje edhe për gazetat shqipe dhe të huaja, ky klub jo rastësisht tuboi elitën politike dhe atdhetare të Vilajetit të Kosovës, dhe me këtë dëshmoi se shqiptarët nuk ishin pa aristokracinë e tyre të mendjes dhe revolucionarët e pushkës, të cilët Shkupin e kishin zgjedhur si qendër të veprimit të tyre. Sigurisht që me këtë fakt mbase nuk kanë mundur të pajtohen autorë të lajthitur që vinin nga proveniencat ballkanike, të cilët paturpësisht gënjenin opinionin ndërkombëtar mbi, gjoja, mungesën e shqiptarëve për kapacitete shtetndërtuese. Klubi i Shkupit jo vetëm se i demantoi këto konstruktë dashakeqe propagandistike, por konfirmoi gatishmërinë dhe aftësinë e shqiptarëve për të menaxhuar situata sipas nevojave e rrethanave që kërkoheshin. Mjafton të lexohen raportet e konsujve të huaj të cilët shkruanin, bie fjala, për ditët e Shkupit të çliruar nga kryengritësit shqiptarë, në ditët dhe javët e verës së vitit 1912, ku rendi dhe qetësia publike ishin vendosur si një përfitim për të gjithë banorët e qytetit, pa dallim përkatësinë e tyre etnike e fetare.

I pagëzuar me emrin “Bashkimi”, sipas shembullit të klubit të Manastirit, Klubi i Shkupit, siç na e bëjnë të ditur burimet e shumta arkivore e dokumentuese që i ka përdorur prof.dr. Ramiz Abdyli, kishte një fushëveprim njëaft aktiv, që si detyrë parësore kishte ndërgjegjësimin kombëtar të shkupjanëve në rrethinë dhe në Vilajetin e Kosovës, duke i dhënë jo pak hapësirë angazhimeve që do të kthjellonin kombëtarisht e kulturalisht edhe elementin shqiptar pro xhonturk të qytetit. Me këtë mund t’i përshkruhet edhe një meritë tjetër këtij Klubi, i cili kishte arritur të kontribuojë në orientimin properëndimor të shqiptarëve në një periudhë ko-

hore kur për fatin e tyre vendosnin vendimet e padrejta të konferecave ndërkombëtare.

Klubi i “Bashkimi” i Shkupit e kishte hierarkinë e organizimit dhe veprimet, kurse Pleqësia ishte organi suprem që merrte vendime të rëndësishme. Pjesë e atyre veprimeve ishte edhe propaganda, që u sublimua me themelimin gazetës “Shkupi” e drejtuar nga publicisti dhe atdhetari, Jashar Erebara.

Klubi “Bashkimi” i Shkupit nuk ishte një organizëm i izoluar nga hapësira etnike shqiptare, prandaj ky ishte edhe qëllimi që me iniciativë të këtij klubi u hapën edhe klube të tjera në disa qytete të Vilajetit të Kosovës, si në Kumanovë, Mitrovicë, Tetovë e gjetiu.

Periodha në të cilën veproi Klubi i Shkupit, siç rezulton nga hulumtimet arkivore të prof. Ramizit, përkon me disa zhvillimeve politike që i ndërmerre administrata xhonturke në instalimin e frymës përjashtuese të elementit shqiptar nga jeta publike e administrative si dhe në favorizimin e alfabetit arabo-osman, një tendencë kjo në kundërshtim me vendimet e Kongresit të Manastirit që kishin të përvetësuar shkronjat latine si bazë e alfabeti të ri të unifikuar.

Se Klubi i Shkupit vepronte sipas një disipline dhe një hierarkie mjaft të strukturuar, flet edhe mënyra e organizimit të tij, ku si pjesë përbërëse ishte edhe Komiteti i fshehtë, një ndër komitetet më të shquara në Shqipëri, që i kushtojë kryesisht çështjeve që kishin të bënin me përgatitjen e rezistencës së armatosur që do të pasonte.

Veprimtaria e Klubit “Bashkimi” të Shkupit nuk mund të shikohet e veçuar nga konteksti i ngjarjeve që po ndodhnin në atë hark kohor 1908–1912, dhe sidomos në fazën kulmore që u arrit me çlirimin e Shkupit. Mbështetur në kronikat e gazetave të kohës dhe në raportet e konsujve, autori na e bën shumë të afërt atmosferën e çlirimit të Shkupit, e cila dominohej nga lajmet e përhapura për marshimin e kryengritësve drejt kryeqytetit Dardan

Shkupit. Pjesë e kësaj atmosfere ishte edhe pritja që iu bë kryengritësve shqiptarë nga mijëra shkupjanë, të shoqëruar nga orkestrina “Zana e Malit”, që ishte pjesë përbërëse e Klubit “Bashkimi” të Shkupit.

Ku qëndron rëndësia e kësaj monografie?

Përpos që vjen me një aparaturë të konsoliduar shkencore dhe me burime të pasura bibliografike, autori, prof.dr. Ramiz Abdyli, për herë të parë në historiografinë tonë sjell të plotë veprimtarinë e një klubi në hapësirën e dikurshme shqiptare që ishte unike.

Klubi i Shkupit fuzionoi shqiptarët e të gjitha krahinave e të gjitha religjioneve dhe u bë, kështu, zëri më artikulues i interesave kombëtare në prag të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Meritë tjetër e këtij klubi është edhe oksidentalizimi i veprimit kolektiv të shqiptarëve, si në rrafshin politik, ashtu edhe në atë arsimor e kulturor. Por, të gjitha këto detaje e risi nuk kanë mundur të dalin dhe të bëhen pjesë e interesimit të lexuesit të sotëm, pa insistimin këmbëngulës të autorit – Prof. dr. Ramiz Abdylit, i cili përpos tjerash këtë vepër na e bëri edhe më të dashur me stilin e tij të shkruarit konciz e përmbajtësor, një vlerë kjo që e karakterizon gjithë opusin e tij shkencor e hulumtues.

SHTOJCË – FOTOGRAFI













Botues:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 33 – 2022

Kryeredaktor: Besnik Rameti
Përgjegjës i botimit: Sevdail Demiri
Redaktor teknik: Naser Fera

Shypi: DataPons – Shkup
Rr. 1550, nr. 52, Vizbeg
Tirazhi: 500 copë

*Ky edicion i SCUPI-t botohet me vendimin e Këshillit të
ITShKSh-Shkup, nr. 0201–109/8, të datës 24.01.2022, si pjesë e
programit të punës së Institutit për vitin 2022*

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

930:929Абдули,Р.(062)

RAMIZ Abdyli, studiuesi model i historiografisë shqiptare :
(konferencë e mbajtur më 10 qershor 2021) / [kryeredaktor Besnik
Rameti]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të
shqiptarëve, 2022. - 104 стр. : илустр. ; 21 см. - (Biblioteka Scupi ; v. 33)

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4897-67-5

а) Абдули, Рамиз, 1934- -- Историографија -- Собири

COBISS.MK-ID 58430469